



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA –REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të :

AC-I-16-0101 – A22

Paditësit/Ankuesit

1.A0001 Y. Q, Ferizaj.

2.A0002 F. T, përfaqësuar nga Av. J. R, Ferizaj.

3.A0003 N. Q, përfaqësuar nga Av. J. R, Ferizaj.

4.A0004 M. B, Ferizaj.

5.A0005 T. H, përfaqësuar nga Av. J. R, Ferizaj.

6.A0006 H. (H) R Ferizaj.

7.A0008 R. (S) J, Ferizaj.

8.A0009 I. (A) R, Ferizaj.

9.A0010 D. E,

Sh. A

B. K

F. B-M

H. H

S. R

R. R, të gjithë përfaqësuar nga Av. M. H, Ferizaj.

10.A0011 S. S, Shtërpcë.

11.A0012 J. S V, Shtërpcë.

12.A0013 B. S, Ferizaj.

13.A0014 S. R, përfaqësuar nga Av. J. R, Ferizaj.

14.A0015 B. M, përfaqësuar nga Av. V. M, Ferizaj.

15.A0016 H. (L) Xh, Ferizaj.

16.A0017 S. (M) N

L. L

S. S

Z. M,

B. P dhe

M. R të gjithë përfaqësuar nga Av. D. V.

17.A0018 R. A

Sh. H

H. H

K. B

D. H

Sh. F

N. I

J. K

S. M

D. P

Y. Q

H. R

M. R

B. S

Sh. S

S. Sh

H. Sh

N. Sh

Sh. S

B. S

S. H

K. V

S. R dhe

S. H, Përfaqësuar nga Av. K. A, Shtime.

18.A0019 V. (D) D, Zemun, Serbi.

19.A0020 D. (M) S, Obrenovac, Serbi.

20.A0021 M. (S) S, Obrenovac, Serbi.

21.A0022 S. (R) Sh, Ferizaj

Kundër:

E paditura/Ankuesja

A0007 Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rr. "Agim Ramadani" nr. 23, Prishtinë.

Kundër:

Ankuesit në shkallë të parë

1. **C0001 – I. (I) G**
2. **C0002 – Lj. (P) S Č**
3. **C0003 – S. (B) Č J**
4. **C0004 – Z. (N) P**
5. **C0005 – V. (M) R P**
6. **C0007 – V. (S) S Đ**
7. **C0009 – V. (S) M**
8. **C0010 – S. (Lj) I**
9. **C0011 – S. (Đ) S J**
10. **C0012 – S. (Ž) B S**
11. **C0013 – R. (B) N V**
12. **C0014 – R. (K) S M**
13. **C0015 – N. (V) P**
14. **C0016 – N. (J) S U**
15. **C0018 – M. (I) M C**
16. **C0019 – L. (B) R M**
17. **C0020 – D. (S) D**
18. **C0021 – D. (Lj) I**

19. C0031 – V. (N) T T

20. C0033 – S. (D) D

21. C0039 – P. (D) A

22. C0042 – Z. (D) A R

23. C0051 – R. (M) I

24. C0052 – V. N

25. C0053 – D. Č

- M. Lj

- S. D

- S. Z

- S. S

- S. S

- M. S

- S. S

- M. M

- M. J

- M. D

- S. V

26. C0032, C0034, C0035, C0044 dhe C0045

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Sabri Halili, Mr. Sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesve, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-sh, SCEL-11-0057, të datës 18 prill 2016, në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 04/02/2020 lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesat A0001 Y. Q, A0002 F. T, A0003 N. Q, A0005 T. H, A0013 B. S, Ankesa A0014 S. R A0017 L. L, A0018, R. A, Sh. H, K. B, H. R, M. R, N. Sh, Sh. S B. S, S. H, Sh. S, D. H dhe S. H, A0019 V. (D) D, A0020 D. (M) S dhe A0021 M. (S) S, aprovohen si të bazuara dhe obligohet AKP-ja që të lartcekurit t`i përfshijë në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar me të drejta legjitime, përfitues të 20 % nga privatizimi i NSH-së " N", Ferizaj.
2. Ankesat, A0004 M. (R) B, A0006, H. (H) R, A0008, R. (S) J, A0009, I. (A) R, A-0018, H. H, Sh. F, N. I, J. K, S. M, D. P, S. Sh, H. Sh, K. V dhe S. R dhe, A0022 S. (R) Sh refuzohen si të pa bazuara dhe vërtetohet Aktgjykimi SCEL-11-0057 i datës 18 prill 2016, lidhur me këta ankues.
3. Ankesa e AKP-së A0007, lidhur me punëtorin V. N, aprovohet si e bazuar ,ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar lidhur me këtë punëtorë dhe e njëjta hiqet nga lista e punëtorëve të kualifikuar ,përfituese e 20 % nga privatizimi i NSH-së " N", Ferizaj.
4. Ankesa e AKP-së A0007, aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet pika e -I- e dispozitivit të Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS , SCEL-11-0057, të datës 18 prill 2016, lidhur me punëtorin Sahit Krasniqi i njëjtit i plotëson kushtet për të mbetur në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar me të drejta legjitime, përfitues të 20 % nga privatizimi i NSH-së "17 N", Ferizaj.
5. Ankesa e AKP-së A0007, lidhur me punëtorët C0001- I. (I) G, C0002- Lj. (P) S Č, C0003-S. (B) Č J, C0004-Z (N) P, C0005-V. (M) R P,

C0007-V. (S) S Đ, C0009- V.(S) M, C0010- S. (Lj) I, C0011- S (Đ) S J, C0012-S (Ž) B S, C0013-R. (B) N V, C0014- R. (K) S M, C0015-N. (V) P, C0016- N. (J) S U, C0018- (I) M C C0019-L. (B) R M, C0020-D. (S) D, C0021-D. (Lj) I, C0031-V. (N) T T, C0033-S. (D) D, C0039-P. (D) A R, C0042-Z. (D) A , C0051-R. (M) I, C0053 – D.Č, -M Lj,- S. D, - S. Z, -S. S, - S. S1, -M. S, - S. S2, -M. M, -M. J, -M. D,- S. V, refuzohet si e pa bazuar të lartcekurit i plotësojnë kushtet për të mbetur në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar me të drejta legjitime, përfitues të 20 % nga privatizimi i NSH-së " N", Ferizaj.

6. Ankesa A0010 D. E etj, refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi, SCEL-11-0057 i datës 18 prill 2016, punëtorët ndaj të cilëve është ushtruar ankesa, V. A, M. A, Q. B, S. B, A. F, F. G, S.G, H. H, R. H, B. H, I. J, M. J, F. M, B. M, A. N, S. N, I. O, Xh. Q, H. R, B. R, I. Rr, I. S, H. Sh, F. S, R. H, A. R, H. A, S. T, M. V, Xh. Z, K. Z dhe N. Z, i plotësojnë kushtet për të mbetur në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar me të drejta legjitime, përfitues të 20 % nga privatizimi i NSH-së " N", Ferizaj.
7. Ankesat A0011, S. S, A0012 J. S, A0016 H. (L) Xh dhe A0022 S. (R) Sh, refuzohen si të pa bazuara dhe vërtetohet Aktgjykimi SCEL-11-0057 i datës 18 prill 2016.
8. Ankesa A0015, B. M, hedhet poshtë si e pa pranueshme, i njëjti është i përfshirë në listën përfundimtare të punëtoreve të shpallur nga AKP-ja.

- 9.** Ankesa A0017, S. (M) N, S. S dhe Z. M refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi SCEL-11-0057, të datës 18 prill 2016, të njëjtit nuk i plotësojnë kushtet për tu përfshirë në listën përfundimtare.
- 10.** Ankesa A0017 sa i përket ankuesve B. P dhe M. R, hedhet poshtë si e pa pranueshme.
- 11.** Nuk caktohen taksa për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe gjendja faktike

Ratifikimi i kontratës së parë në mesë të AKM-së dhe blerësit lidhur me ndërmarrjen shoqërore " N" në Ferizaj, është bërë me 17 prill 2007.

Lista e punëtorëve që kanë të drejtë legjitime në 20 % të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së ishte publikuar nga AKP-ja me 27, 28 dhe 29 tetor 2001.

Afati i fundit për paraqitjen e ankesave në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS) ka qenë data 19 nëntor 2011.

Ndaj listës përfundimtare ishin parashtruar 58 ankesa.

Ankuesit kanë pretenduar se ishin punëtor të NSH " N" në Ferizaj, e cila ishte privatizuar nga e paditura.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, me Aktgjykimin SCEL -11-0057, të datës 18 prill 2016 ka vendosur:

I. Aprovohen ankesat e ankuesve në vijim si të bazuara. E Padituri Agjencia Kosovare e Privatizimit urdhërohet që t'i përfshijë këta ankues në listën përfundimtare të punëtorëve që gëzojnë të drejtën legjitime për një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH " N" -Ferizaj :

C0001- I. (I) G, C0002-Lj. (P) S Č, C0003-S. (B) Č J, C0004-Z. (N) Pežić, C0005-V. (M) R P, C0007-V. (S) S Đ, C0009- V. (S) M, C0010- S. (Lj) I, C0011- S. (Đ) S J, C0012-S. (Ž) B S, C0013-R. (B) N V, C0014- R. (K) S M, C0015- N. (V) P , C0016- N. (J) S U , C0018-M. (I) M C, C0019-L. (B) R M , C0020- D. (S) D , C0021-D. (Lj) I, C0031-V. (N) T T, C0033-S. (D) D, C0039-P. (D) A R, C0042-Z.(D) A , C0051-R. (M) I, C0052-V. N , C0053 – D. Č, -M Lj, - S D, - S. Z, -S. S, - S S1, -M. S, - S. S2, -M. M, -M. J, -M. D, - S. V, C0055-B. (F) H (gjendet në listën përfundimtare).

II. Refuzohen si të pa bazuara ankesat e ankuesve:

C0006- V. (S) Đ P, C0008-V. (D) D, C0017-M. (S) S, C0022-D. (M) S, C0023-B. (S), M N, C0024-N. Q, C0025-T. H, C0026-F. T, C0027-I. (A) R, C0028-H. (H) R, C0029- M. (R) B, C0030-E. (A) E, C0035-R. (S) J, C0036-S. (A) H, C0037-G. (Rr)A, C0038-A. t S, C0040-M. (M) K, C0041-R. (G) S, C0046-Z. G I, C0047-D. (R) J, C0048-Z. (T) R, C0049-V. J, C0050-Lj. (D) S, C0052-V. N, C0053-S. N, -L. L, -S. S, - M. Z.

III. Hudhen si të PA PRANUESHME ankesat e ankuesve:

C0054-H. (L) Xh, C0056-S. (R) Sh, C0057- J. S, C0058-S. S.

IV. Refuzohet kërkesa e ankuesve C-0032, C0034, C0035, C0036, C0044 dhe C0045 për largim nga lista e publikuar përfundimtare për punëtorët e poshtëshënuar të cilët ishin përfshirë nga AKP-ja. Punëtorët mbesin në Listë për përfitimin e 20%.

-V. A, - M. A, - Q. B, - S. B, - A. F, F. G, - S. G, - H. H, - Rr. H, - B. H, - I. J, - M J, - F. M, - B. M, - A. N, - S. N, - I. O, - Xh. Q, - H. R, - B. R, - I. R, - I. S, - H. Sh, - F. S, - R. H, - A.R,- H. A, - S. T, - M. V, - Xh. Z, - K. Z, - Nj. Z, -E. T, - Sh. B, - B. A, - Q. B, Sh. A, -M. H, - B. K, -R. R,- F. B, - H. H, - S. R, - D. E, -Z. A, -B. Z,

-B. Č, - R. Ć, -M. D, -S. D, -Z. J, -M. D, -S. P, -N. K, -B. L, -N. M, -M. M, -Z. D S, - S. S, -V. S, -Lj. N, -S. N, -B. P, -D. P.

V. Aprovohet kërkesa e ankuesve C-0032, C0034, C0035, C0036, C0044 dhe C0045 për largim nga lista e publikuar përfundimtare për punëtorët e poshtëshënuar të cilët ishin përfshirë nga AKP-ja. Këta punëtor largohen nga Lista për përfitimin e 20%.

- R. A, - Sh. H, - H. H, -K. B, - D H,- Sh. F, - N. I, - J. K, - S. K,-S. M, - D. P, - Y. Q,
- H. R, - M. R, B. S, -S. S, -S.i Sh, -H. Sh, -N. Sh, -Sh. S, -B. S, -S. H, -K. V
dhe -S R.

Ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar SCEL-11-0057, të datës 18 prill 2016, ankesë ka paraqitur e paditura AKP-ja dhe ankuesit si në vijim:

A0001 Ymer Qorolli

Me 18 maj 2016 **Ankuesi A0001 – Y. Q**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL-11-0057, të datës 18 prill 2016 (me tutje Aktgjykimi i ankimuar) për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 182.2 nën pika n të LPK-së, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike nga neni 183.1 të LPK-së dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Ankuesi ka pohuar se dispozitivi i Aktgjykimit të ankimuar është i pa qartë dhe kundërthënës me brendinë e vetë përkitazi me faktet vendimtare si dhe arsyet e prezantuara në arsyetimin e këtij Aktgjykimi. Po ashtu ankuesi ka pohuar se ekzistojnë të gjitha faktet dhe provat se ai ka qenë punëtor i NSH-së dhe se nuk ka ndonjë vendim të organit kompetent për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, e që ka pas për obligim kjo ndërmarrje në momentin e mbylljes së librezës së punës ti bie vendim mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës e këtë nuk e ka bërë. Ankuesi ka pohuar se është diskriminuar për shkak të mos realizimit të së drejtës

së 20 % nga shitja e kësaj NSH-je. Si provë ka bashkangjitur kopjen e librezës së punës, kopjen e vërtetimit mbi përvojën e punës dhe kopjen e listës përfundimtare të shpallur nga AKP-ja.

A0002 F. T

Me 18 maj 2016 **Ankuesi A0002 – F. T**, përmes të autorizuarit të tij Av. J. R, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjyqimit, SCEL-11-0057, të datës 18 prill 2016 (më tutje Aktgjykimi i ankimuar) për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljes se dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 182.2 nën pika n të LPK-së, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike nga neni 183.1 të LPK-së dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare apo çështja të kthehet ne rigjykim.

Ankuesi ka pohuar se dispozitivi i aktgjyqimit të ankimuar është i pa qartë dhe kundërthënës me brendinë e vetë përkitazi me faktet vendimtare si dhe arsyet e prezantuara në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

Po ashtu ankuesi ka pohuar se një e drejtë e tillë i takon për vet faktin se ankuesi ka punuar për atë periodë kohore dhe i ka realizuar të drejtat për realizimin e 20 % nga shitja e kësaj NSH-je. Ankuesi ka pohuar se është diskriminuar për shkak të mos realizimit të së drejtës së 20 % nga shitja e kësaj NSH-je. Si provë ka bashkangjitur kopjen e librezës së punës, kopjen e vendimit të datës 19 gusht 2002, kopjen e letërnjoftimit dhe autorizimin për përfaqësim.

A0003 N. Q

Me 18 maj 2016 **Ankuesi A0003 – N. Q**, përmes të autorizuarit të tij Av. J. R, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjyqimit, SCEL-11-0057, të datës 18 prill 2016 (më tutje Aktgjykimi i ankimuar) për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljes se dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 182.2 nën pika n të LPK-së, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike nga neni 183.1 të LPK-së dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së, me propozim që

ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare apo çështja të kthehet ne rigjykim. Ankuesi ka pohuar se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i pa qartë dhe kundërthënës me brendinë e vetë përkitazi me faktet vendimtare si dhe arsyet e prezantuara në arsyetimin e këtij aktgjykimi. Po ashtu ankuesi ka pohuar se një e drejtë e tillë i takon për vet faktin se ankuesi ka punuar për atë periodë kohore dhe i ka realizuar të drejtat për realizimin e 20 % nga shitja e kësaj NSH-je. Ankuesi ka pohuar se është diskriminuar për shkak të mos realizimit të së drejtës së 20 % nga shitja e kësaj NSH-je. Si provë ka bashkangjitur kopjet e vendimeve për lejimin e mungesës nga puna pa pagesë.

A0004 M. (R) B

Me 18 maj 2016 **Ankuesi A0004 – M. (R) B**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL-11-0057, të datës 18 prill 2016, (më tutje Aktgjykimi i ankimuar) me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe çështja të kthehet ne rigjykim. Ankuesi ka pohuar se mos mbyllja e librezës së punës ka si rrjedhojë neglizhencën e administratës me të cilën ka udhëhequr ish drejtori Q. B dhe si përgatitje e qëllimshme që disa punëtor të mbesin të regjistruar gjerë në kohën e privatizimit, po ashtu ankuesi i ka kontestuar disa punëtor që janë përfshirë në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se ka ushtruar ankesë për hire të drejtësisë dhe të vërtetës që provat të kërkohen në AKP nëpërmjet dokumentacionit në disponim, po ashtu ka pohuar se nuk është kundër punëtorëve legjitim që me të vërtet iu takon kjo e drejtë por se është kundër atyre dhe ndihmësve të tyre që në mënyrë korruptive mundësohen që të përfitojnë në dëm të punëtorëve të ndershëm. Si provë ka bashkangjitur kopjet e vendimit per ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 07/12/1991 , kopjen e vendimit mbi shfrytëzimin e pushimit vjetor te datës 19/08/1991si dhe autorizimin.

A0005 T. H

Me 18 maj 2016 **Ankuesi A0005 – T. H**, përmes të autorizuarit të tij Av. J. R, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL-11-0057, të datës 18 prill 2016 (më tutje Aktgjykimi i ankimuar) për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të

gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 182.2 nën pika n të LPK-së, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike nga neni 183.1 të LPK-së dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare apo çështja të kthehet në rigjykim. Ankuesi ka pohuar se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i pa qartë dhe kundërthënës me brendinë e vetë përkitazi me faktet vendimtare si dhe arsyet e prezantuara në arsyetimin e këtij aktgjykimi. Po ashtu ankuesi ka pohuar se një e drejtë e tillë i takon për vet faktin se ankuesi ka punuar për atë periudë kohore dhe i ka realizuar të drejtat për realizimin e 20 % nga shitja e kësaj NSH-je. Ankuesi ka pohuar se është diskriminuar për shkak të mos realizimit të së drejtës së 20 % nga shitja e kësaj NSH-je. Si provë ka bashkangjitur aktvendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës pa pëlqimin e punëtorit, kopjen e vendimit të datës 19 gusht 1991, kopjen e raportit mbi konstatimin e gjendjes pas regjistrimit të njësisë afaristë në NSH, autorizimin për përfaqësim dhe vërtetimin lëshuar nga drejtori i NSH-së.

A0006 H. (H) R

Me 18 maj 2016 **Ankuesi A0006 – H. (H) R**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL-11-0057, të datës 18 prill 2016, (më tutje Aktgjykimi i ankimuar) me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se ka qenë punëtor i NSH-së plotë 43 vjet 5 muaj e 16 ditë se NSH-ja u krijua me kontributet e punëtorëve, po ashtu ankuesi ka pohuar se ka qenë punëtor i rregullt edhe tri vite pas hyrjes në fuqi të rregullores së UNMIK-ut. Ankuesi ka pohuar se po kërkon djersën e tij që ka derdhur, po ashtu pohon se punësimi përfundon por jo edhe borxhi.

Ankesat e lartcekura i janë dorëzuar AKP-së me datë 06 gusht 2018 dhe e njëjta nuk ka parashtruar përgjigje.

A0007 Agjencia Kosovare e Privatizimit

Me 18 maj 2016 **Ankuesja A0007- AKP-ja**, ka parashtruar ankesë kundër pikës së parë me përjashtim të ankuesit ,C-0055 , B. (F) H dhe pikës së pestë të dispozitivit të Aktgjykimit, SCEL-11-0057 të datës 18 prill 2016, (më tutje Aktgjykimi i ankimuar) për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, Kolegjit të Apelit i propozon që ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe anulon aktgjykimin SCEL-11-0057 në pjesën e atakuar. AKP-ja ka pohuar se në bazë të arsyetimit ligjor të aktgjykimit, për një pjesë të ankuesve, si arsye kryesore, përfshirjen e punëtorëve në listën përfundimtare me të drejta legjitime për marrjen e një pjese të ardhurave nga privatizimi i NSH-së është diskriminimi. Sipas ankueses ankuesit duhet të ofrojnë fakte dhe prova nga të cilat mund të parashikohet diskriminimi direkt apo indirekt dhe vetëm nëse këto fakte dhe prova parashtrohen, e paditura duhet të sjellë kundër argumente dhe prova se nuk ka pasur qasje diskriminuuese. Sipas ankueses nuk është kontestuese se ka pasur diskriminim dhe atë në të dy anët, por konsideron se diskriminimi është një akt individual dhe në secilin rast konkret duhet të provohet, pasi në kontestin e mbrojtjes nga diskriminimi është shumë vështirë që me siguri të provohet që pabarazia në qasje është motivuar nga ndonjë prej veprimeve të ndaluara diskriminuuese. Po ashtu ankuesja ka pohuar se në rastin konkret asnjë ankues i nacionalitetit serb që është përfshirë në listën përfundimtare nuk ka prezantuar fakte relevante në bazë të të cilave kishte për tu vërtetuar faktin e tretmanit jo të barabartë dhe arsyetimin për aplikimin e diskriminimit direkt apo indirekt në pajtim me nenin 8.1 të Ligjit kundër Diskriminimit. Ndërsa sa i përket ankueses C0052 V. N në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar ajo gjendet në mesin e ankuesve nën pikën -I- të pranuarit, ndërsa në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar konstatohet se ankesa e saj refuzohet si e pa bazuar, andaj konsideron se është bërë gabim teknik dhe se ankesa e ankueses sipas arsyetimit të aktgjykimit të atakuar duhet të refuzohet. AKP-ja e atakon edhe pikën e pestë të dispozitivit të aktgjykimit të lartcekur duke specifikuar të dhëna për secilin ankues të cilët duhet të mbesin në listën përfundimtare me të drejta legjitime. AKP-ja konsideron se Aktgjykimi i kundërshtuar i Dhomës së Posaçme është jo konsistent, i pa argumentuar në bazë të ligjit të aplikueshëm, nuk i përmban faktet vendimtare dhe në mënyrë arbitraren e interpreton drejtën e aplikueshme.

Ankesa e AKP-së, i është dorëzuar palëve kundërshtare.

Më 13 qershor 2016 përgjigje në ankesë ka parashtrua S. J, e cila ankesën e AKP-së e kundërshton në tërësi si të pa bazuar.

Më 13 qershor 2016 përgjigje në ankesë ka parashtrua S. I, i cili ankesën e AKP-së e kundërshton në tërësi si të pa bazuar.

Më 13 qershor 2016 përgjigje në ankesë ka parashtrua D. I, i cili ankesën e AKP-së e kundërshton në tërësi si të pa bazuar.

Më 17 qershor 2016 përgjigje në ankesë ka parashtrua V. T, e cila ankesën e AKP-së e kundërshton në tërësi si të pa bazuar.

Më 17 qershor 2016 përgjigje në ankesë ka parashtrua Lj. C, e cila ankesën e AKP-së e kundërshton në tërësi si të pa bazuar.

Më 05 shtator 2018 përgjigje në ankesë ka parashtrua V. M, e cila ankesën e AKP-së e kundërshton në tërësi si të pa bazuar.

A0008 R. (S) J

Me 19 maj 2016 **Ankuesi A0008 – R. (S) J**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, (më tutje Aktgjykimi i ankimuar) me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se ka qenë punëtor i NSH-së që nga data 07 shkurt 1973 e gjerë me 30 shtator 2006 dhe se në kohën e shpalljes së privatizimit të NSH-së ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune, deri në përfundimin e valës së parafundit kur edhe ka arrit kohën e pensionimit, po ashtu ankuesi ka pohuar se nuk është e vërtet se në kohën e privatizimit të ndërmarrjes ka qenë në moshën e pensionimit pasi që ka lindur me 1941 dhe në kohën e privatizimit ishte mbi moshën 65 vjeç, por pohon se ka qenë në marrëdhënie të

rregullt pune gjerë në valën e fundit të privatizimit të NSH-së siç dokumentojnë dhe argumentojnë regjistrat për pagesën e fitimeve që ja bashkëngjisim si provë.

A0009 I. (A) R

Me 19 maj 2016 **Ankuesi A0009 – I. (A) R**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, (më tutje Aktgjykimi i ankimuar) me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se nuk është marrë parasysh kontributi i tij dhe i punëtorëve tjerë që kanë ndarë për 40 vite, kanë krijuar këtë pasuri që është shitur për një copë bukë, sipas ankuesit gjykata ka pasur parasysh vetëm ligjin e punës ku ceket se punësimi përfundon kur punëtori arrin moshën e pensionimit prej 65 viteve por kjo nuk e ndalon që të kërkohen borxhet nga NSH-ja ne qoftë se ajo ka ndonjë obligim.

A0010/1 D. E, 2.Sh. A ,3. B. K, 4. F. (B) K, 5.H. H, 6. S. R dhe 7. R. R.

Me 19 maj 2016 **Ankuesit A0010/1–7 D. E** përmes të autorizuarit Av. M. H, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, (më tutje Aktgjykimi i ankimuar) për shkak të futjes në listën e pagave të punëtorëve nga numri rendor 1-55 si dhe numër C-044, me pretendimin se Aktgjykimi i ankimuar është nxjerrë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankuesit kanë pohuar se Kolegji i Specializuar e ka aprovuar pjesërisht ankesën e tyre, duke mos e aprovuar kërkesën për largimin e personave nga lista e përfituesve me numër C-0032-1-55 si dhe C-0044 edhe pse provat materiale ishin mjaft bindëse të cilat konfirmonin se personat e tillë ishin posedues të bizneseve dhe personat fizik dhe të cilët nuk disponojnë të drejta legjitime të inkuadrohen në listën e përfitimit të 20 % të aseteve të shitura të NSH-së. Si provë kanë bashkëngjitur disa kontrata të qirasë mbi lokalet afariste, kopjen e regjistrit për pagesën e pagave mujoren, kopjen nga libri amzë dhe autorizimin për përfaqësim.

Ankesa e lartcekur i është dorëzuar përfaqësuesit të punëtorëve të kontestuar Av. K. A, me datë 26 shtator 2018 dhe i njëjti ka parashtruar përgjigje duke e kundërshtuar ankesën dhe duke pohuar se është e qartë se ankesa është tërësisht

e pabazë dhe e orientuar në drejtim të zvarritjes së këtij procesi andaj edhe duhet të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

A0011 S. S

Me 20 maj 2016 **Ankuesja A0011 – S. S, ,** ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, Ankesat e lartcekura i janë dorëzuar AKP-së me datë 06 gusht 2018 dhe e njëjta nuk ka parashtruar përgjigje. me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e saj për futje në listën përfundimtare. Ankuesja ka pohuar se është e vërtet se ankesën e ka paraqitur pas kalimit të afatit por AKP-ja le ta vërtetoj se a e ka njoftuar ndonjëherë prej 19 nëntorit 2011 kur për herë të parë ka parashtruar ankesë dhe ta dëshmoj se në vendqëndrimin e saj kurrfarë shtypi ditor kosovar nuk arrin as në gjuhën serbe por as në gjuhën shqipe, po ashtu pohon se në gazetën zyrtare nuk ka qasje pasi që nuk është e moshës së re dhe nuk ka qasje në internet dhe ne faqet tjera elektronike. Ankuesja ka pohuar se që nga data 01 korrik 1992 e gjerë në qershor të vitit 1999 ka punuar në NSH dhe detyrat punuese i ka kryer me përgjegjësi të plotë dhe rezultate të larta në punë.

A0012 J. S

Me 20 maj 2016 **Ankuesja A0012 – J. S, ,** ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, Ankesat e lartcekura i janë dorëzuar AKP-së me datë 06 gusht 2018 dhe e njëjta nuk ka parashtruar përgjigje. me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e saj për futje në listën përfundimtare. Ankuesja ka pohuar se është e vërtet se ankesën e ka paraqitur pas kalimit të afatit por AKP-ja le ta vërtetoj se a e ka njoftuar ndonjëherë prej 19 nëntorit 2011 kur për herë të parë ka parashtruar ankesë dhe ta dëshmoj se në vendqëndrimin e saj kurrfarë shtypi ditor kosovar nuk arrin as në gjuhën serbe por as në gjuhën shqipe, po ashtu pohon se në gazetën zyrtare nuk ka qasje pasi që nuk është e moshës së re dhe nuk ka qasje në internet dhe ne faqet tjera elektronike. Ankuesja ka pohuar se që nga data 08 shkurt 1988 e gjerë në qershor të vitit 1999 ka punuar në NSH dhe detyrat punuese i ka kryer me përgjegjësi të plotë dhe rezultate të larta në punë.

A0013 B. S

Me 20 maj 2016 **Ankuesi A0013 – B. S**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se me aktgjykimin e atakuar është aprovuar ankesa e ankuesve për përjashtimin e tij nga lista përfundimtare ashtu që ankuesin si punëtor shumë vjeçar të ndërmarrjes e ka përjashtuar nga lista përfundimtare, po ashtu ankuesi pohon se Kolegjit të Apelit i ofron një mori dokumentesh të cilat vërtet flasin se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së dhe se i është ndërprerë marrëdhënia e punës siç shihet nga librezja e punës me 11 tetor 1995. Ankuesi ka pohuar se ndaj tij është ushtruar një lloj diskriminimi nga ana e drejtorit i cili përkundër punës ai nuk i ka bartë shënimet në regjistrat përkatës- në librezën e punës pasi që pretendon se edhe ankuesi ka punuar dhe i ka përjetuar sfidat e njëjta sikurse punëtorët tjerë të cilët kanë mbetur në listë. Si provë ka bashkangjitur kopjen e librezës së punës, vendimin e datës 13 nëntor 1985, kopjen nga libri amzë, vendimin e datës 01 qershor 1992 dhe kopjen e letërnjoftimit.

A0014 S. R

Me 24 maj 2016 **Ankuesi A0014– S. R, përmes të autorizuarit Av. E. Sh**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se aktgjykimi është marrë mbi bazën e gabuar faktike pasi që në listën përfundimtare të AKP-së figuron Salih Rexhepi dhe një Sali Rexhepi e që në fakt është i njëjti person, mirëpo ankuesit emri i është regjistruar në ndërmarrjen N. si dhe në listën e pagave si S. R ndërsa i njëjti në realitet e ka S. R kjo vërtetohet nga vërtetimi i lëshuar nga organet komunale, po ashtu ankuesi ka pohuar se S. R nga fshati S, Komuna e Ferizajt, me numër personal 1005021207 të lëshuar MPB e Republikës së Kosovës ka qenë furnizues i shitores dhe shitës i mallit, kjo dokumentohet nga kontrata e punës ndërsa S. R tjetër i cili figuron në listë ka qenë qiramarrës para vitit 2000. Sipas ankuesit, ai është larguar nga lista përfundimtare në sajë të një keqkuptimi apo

gabimit në raport me personalitetin e ankuesit S. R. Si provë ka bashkangjitur kopjen e kontratës së punës të datës 01 shtator 1999, kopjen e librezës së punës, kopjen e listës përfundimtare të shpallur nga AKP-ja, kopjen e regjistrimit mbi pagesën e pagave, vërtetimin e lëshuar nga organet komunale në Ferizaj, kopjen e njoftimit të pranuar nga AKP-ja dhe kopjen e letërnjoftimit.

A0015 B. M

Me 24 maj 2016 **Ankuesi A0015– B. M, përmes të autorizuarit Av. E. Sh** ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se ka qenë në marrëdhënie pune të pandërprerë deri në momentin e privatizimit të ndërmarrjes shoqërore " N" Ferizaj, mirëpo i njëjti është larguar nga lista duke iu manipuluar dokumentacioni i tij me qëllim që të përfitojë një B. M tjetër nga KK Shtime i cili ka qenë qiramarrës në ndërmarrjen shoqërore " N" dhe se në këto rrethana gjykata Supreme është lajthitur duke e lënë në listën e përfituesve B. M nga KK Shtime, ndërsa në fakt përfitues do të duhej të ishte B. M KK Ferizaj i cili ka qenë punëtor i NSH-së dhe ka punuar më se 37 vite. Si provë ka bashkangjitur kopjen e letërnjoftimit, kopjen e njoftimit nxjerrë nga AKP-ja, kopjen e regjistrimit për pagesën e pagave, kopjen e kontratës së punës dhe kopjen e librezës së punës.

A0016 H. (L) Xh

Me 25 maj 2016 **Ankuesi A0016– H. (L) Xh**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se nuk ka mundur ta ushtrojë ankesën në afatin e paraparë kohor pasi që e ka pasur nën të sëmure, po ashtu ankuesi ka pohuar se është në gjendje të keqe ekonomike dhe për shkak parave nuk ka pas mundësi të bëjë ankesë tek juristi dhe se Agjencinë për ndihmë juridike nuk e ka marrë parasysh. Si prova ka bashkangjitur dokumentacionin mjekësor të nëse së tij për ta arsyetuar lëshimin e afatit.

A0017 S. (M) N

Me 25 maj 2016 **Ankuesja A0017– S. (M) N, Lazarlagic, S. S B. Pdhe M. R** përmes të autorizuarit të tyre AV. D. V, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tyre për futje në listën përfundimtare. Përfaqësuesi i ankuesve ka pohuar se padia është refuzuar me arsyetimin se ankuesit e kishin ndërruar vendin e tyre të punës dhe pohon se këta katër persona janë zhvendosur nga Kosova në qershor të vitit 1999 dhe që aktualisht si persona të zhdukur jetojnë në Serbi, po ashtu përfaqësuesi i ankuesve ka pohuar se gjykata duhet të marrë parasysh faktin se 17 vjet nuk janë pak dhe këta njerëz duhej gjendeshin disi të mbijetonin, ata mund të kenë punuar herë pas here me punëdhënës të tjerë por nuk kanë ndërpre punësimin e tyre në NSH " N" nga Ferizaj. Ndërsa sa i përket ankuesve Bosko Petrovic dhe Mileve Radic dokumentet e nevojshme do të dorëzohen në gjykatë sapo ato të dorëzohen nga ana e tyre.

A0018 R. A etj

Me 26 maj 2016 **Ankuesit A0016/1– R. A etj, përmes të autorizuarit Av. K. A** kanë parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tyre për futje në listën përfundimtare si dhe të obligohet pala që ka bërë kundërshtimin ti paguaj shpenzimet e përfaqësimit sipas tarifës së OAK.

Ankuesi **R. A** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase ky ankues më datë 05 prill 2000 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist, kjo vërtetohet edhe me faktin se marrëdhënia e tij e punës nuk është e mbyllur në librin amë të ndërmarrjes e po ashtu nga se i njëjti ka punuar deri në ditën e privatizimit vërtetohet edhe me vërtetimin e lëshuar nga AKP-ja. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë

vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren në fuqi. Si provë ka bashkangjitur letër konfirmimin nga AKP-ja të datës 12 maj 2016.

Ankuesi **Sh. H/2** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase në vitin 1994 punëtori është larguar në mënyrë diskriminuese nga vendi i tij i punës dhe pas këtij largimi ai ka punuar në një ndërmarrje private për të mbetur gjallë, po të mos ishte diskriminuar ky punëtor do të ishte i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes, po ashtu ankuesi ka pohuar se më datë 01 dhjetor 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist, kjo vërtetohet edhe me faktin se marrëdhënia e tij e punës nuk është e mbyllur në librin amë të ndërmarrjes e po ashtu nga se i njëjti ka punuar deri në ditën e privatizimit vërtetohet edhe me vërtetimin e lëshuar nga AKP-ja. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren në fuqi.

Ankuesi **H. H/3** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase ky ankues më datë 19 maj 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist, marrëdhënia e punës nuk është e mbyllur në librin amë të ndërmarrjes. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë

ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi. Si provë ka bashkangjitur letër konfirmimin nga AKP-ja të datës 12 maj 2016.

Ankuesi **K. B/4** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase në vitin 1995 punëtori është larguar në mënyrë diskriminuese nga vendi i tij i punës dhe po të mos diskriminohej ende do të figuronte si punëtor i NSH-së, po ashtu ky punëtor ka punuar më shumë se tri vite për këtë ndërmarrje andaj ky punëtor i plotëson kushtet që të përfshihet në listën përfundimtare.

Ankuesi **D. H/5** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase në vitin 1995 punëtori është larguar në mënyrë diskriminuese nga vendi i tij i punës dhe po të mos diskriminohej ende do të figuronte si punëtor i NSH-së, po ashtu ky punëtor ka punuar më shumë se tri vite për këtë ndërmarrje andaj ky punëtor i plotëson kushtet që të përfshihet në listën përfundimtare.

Ankuesi **Sh. F/6** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase ky ankues më datë 01 dhjetor 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi.

Ankuesja **N I/7** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase kjo ankuese më datë 03 qershor 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalit afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist. Po ashtu ankuesja ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren në fuqi. Si provë ka bashkangjitur letër konfirmimin nga AKP-ja të datës 12 maj 2016.

Ankuesi **J. K/8** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase ky ankues më datë 14 tetor 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalit afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne , andaj duke pas parasysh se punëtori ka themeluar marrëdhënie pune në ndërmarrje menjëherë pas lufte dhe se kontrata për qiranë ka paraparë që pasi të përfundoj ai do të kthehet në punë dhe ashtu ka ndodhur.

Ankuesi **S. M/9** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase ky ankues më datë 22 maj 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalit afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e

shkalles së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi.

Ankuesi **D. N/10** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase ky ankues më datë 05 qershor 2000 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkalles së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi, kjo vërtetohet edhe nga libri amë i cili nuk është i mbyllur. Si provë ka bashkangjitur dy deklarata të dhënë nën betim dhe një shkresë të datës 16 maj 2000.

Ankuesi **Y. Q/11** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase ky ankues më datë 08 maj 2000 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkalles së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi, kjo vërtetohet edhe nga libri amë i cili nuk është i mbyllur.

Ankuesi **H. R/12** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike dhe faktin se në vitin 1994 punëtori është larguar nga puna në rrethana diskriminuuese dhe po të mos ishte larguar nga puna në këto rrethana ai ende do të ishte i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes, po ashtu ankuesi ka pohuar se më datë 08 mars 2001 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi.

Ankuesja **M. R/13** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase kjo ankuese më datë 01 prill 2001 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe se pas përfundimit të saj mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Po ashtu ankuesja ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi.

Ankuesi **B. S/14** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike dhe faktin se në vitin 1995 punëtori është larguar nga puna në rrethana diskriminuuese dhe po të mos ishte larguar nga puna në këto rrethana ai

ende do të ishte i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes, po ashtu ankuesi ka pohuar se më datë 18 shtator 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi.

Ankuesi **Sh. S/15** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike dhe faktin se në vitin 1995 punëtori është larguar nga puna në rrethana diskriminuuese dhe po të mos ishte larguar nga puna në këto rrethana ai ende do të ishte i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes, po ashtu ankuesi ka pohuar se më datë 18 shtator 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi.

Ankuesi **S. Sh/16** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike, për faktin se ankuesi më datë 08 shtator 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune

me ndërmarrjen. Ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi.

Ankuesi **H. Sh/17** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike për faktin se ankuesi më datë 21 qershor 2002 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi.

Ankuesi **N. Sh/18** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike për faktin se punëtori në vitin 1995 punëtori është larguar nga puna në rrethana diskriminuese dhe po të mos ishte larguar nga puna në këto rrethana ai ende do të ishte regjistruar si punëtor i NSH-së.

Ankuesi **Sh. S/19** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike për faktin se ndërprerja e marrëdhënies së punës në vitin 1993 është bërë në baza diskriminuese nga ish menaxhmenti serb ashtu siç ka ndodhur me shumicën dërmuese të punëtorëve shqiptar, po ashtu ankues ka pohuar se do të ishte i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes po të mos ishte diskriminuar dhe se ankuesi i ka përfshirë të gjitha kriteret për përfshirje në listën përfundimtare.

Ankuesi **B. S/20** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike për faktin se ndërprerja e marrëdhënies së punës në vitin 1991 është bërë në baza diskriminuese nga ish menaxhmenti serb ashtu siç ka ndodhur me shumicën dërmuese të punëtorëve shqiptar, po ashtu ankues ka pohuar se më datë 01 korrik 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi.

Ankuesi **S. H/21** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike për faktin se ndërprerja e marrëdhënies së punës në vitin 1995 është bërë në baza diskriminuese nga ish menaxhmenti serb ashtu siç ka ndodhur me shumicën dërmuese të punëtorëve shqiptar, po ashtu ankues ka pohuar se më datë 01 korrik 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi.

Ankuesi **K. V/22** ka pohuar se ka themeluar marrëdhënie pune në ndërmarrje më datë 10 janar 1977 dhe ka punuar deri me 11 tetor 1995 kur edhe është larguar në mënyrë diskriminuese nga vendi i tij i punës, po ashtu ankues ka pohuar se ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist dhe në bazë të kësaj kontrate ai e ka ruajtur marrëdhënien e punës në ndërmarrje. Ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi.

Ankuesi **S. R/23** ka pohuar se ka themeluar marrëdhënie pune në ndërmarrje më datë 01 tetor 1983 dhe ka punuar deri me 01 shkurt 1985 mirëpo ky punëtor është kthyer në vendin e tij të punës pas lufte dhe më pastaj i njëjti ka nënshkruar kontratë mbi qiranë për lokalin afarist. Ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi.

Ankuesja **S. H/24** ka pohuar se ka filluar punën në NSH me datë 13 maj 1985 dhe ka punuar deri më datë 11 tetor 1995 kur është përjashtuar në mënyrë diskriminuese nga vendi i punës për shkak të etnisë së saj, dihet se gjatë viteve të nëntëdhjeta kemi pasur dëbime masive të punëtorëve shqiptar nga vendet e tyre të punës, ky është fakt notar andaj ankuesja pohon se po të mos ishte diskriminuar do të ishte regjistruar si punëtore e ndërmarrjes dhe se pas përfundimit të luftës ka qenë në pritje për të filluar marrëdhënien e punës por për shkak të mungesës së fondeve asnjëherë nuk është inkuadruar.

A0019 V. (D) D

Me 30 maj 2016 **Ankuesja A0019 – V. (D) D**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesja ka pohuar se nevoja e gjetjes së ndonjë punësimi të përkohshëm ishte e dukshme për të siguruar ekzistencën e familjes, po ashtu ankuesja ka pohuar se punësimin nuk e ka filluar me vullnetin e saj të lirë por kjo ishte forca madhore dhe nuk e ka ditur që punësimi i përkohshëm diku tjetër mund të ishte arsye për përjashtim nga lista e punëtorëve me të drejta legjitime. Ankuesja ka pohuar se ishte njëherë e diskriminuar sepse është detyruar ta lëshoj vendin e punës dhe qytetin e saj dhe se refuzimi i ankesës për shkak të vonesës për të cilën pretendon se nuk ka faj do të nënkuptonte diskriminimin e përsëritur.

A0020 D. (M) S

Me 31 maj 2016 **Ankuesi A0020 – D. (M) S**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 18231 dhe 18232 nen pika n e LPK-së, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike nga neni 183.1 të LPK-së dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se dispozitivi i aktgjykimit është i pa qartë dhe kundërthënës me brendinë e vete përkitazi me faktet vendimtare si dhe arsyet e prezantuara në arsyetimin e këtij aktgjykimi dhe përmbajtjes së vet shkresave të lëndës, po ashtu ankuesi ka pohuar se i takon e drejta në 210 % për faktin se ka punuar në ndërmarrje prej datës 18 korrik 1972 deri në qershor të vitit 1999 ku për shkak të frikës për familjen e tij dhe nga rrethanat e njohura botërisht ka braktisur Ferizajn dhe nuk ka mundur të jetë në marrëdhënie pune pasi që ka qenë i diskriminuar ngase është i nacionalitetit serb. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas braktisjes së qytetit të Ferizajt ka kontaktuar me udhëheqësit e ndërmarrjes për tu kthyer në punë por nga të njëjtit i është

thënë se nuk mund të garantojnë për jetën e tij dhe të familjes andaj nuk ka pasur guxim që të vie pas lufte dhe të vazhdoj punën.

A0021 M. (S) S

Me 31 maj 2016 **Ankuesi A0021 – M. (S) S**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 18231 dhe 18232 nen pika n e LPK-së, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike nga neni 183.1 të LPK-së dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se dispozitivi i aktgjykimit është i pa qartë dhe kundërthënës me brendinë e vete përkitazi me faktet vendimtare si dhe arsyet e prezantuara në arsyetimin e këtij aktgjykimi dhe përmbajtjes së vet shkresave të lëndës, po ashtu ankuesi ka pohuar se i takon e drejta në 210 % për faktin se ka punuar në ndërmarrje prej datës 15 shkurt 1969 deri në qershor të vitit 1999 ku për shkak të frikës për familjen e tij dhe nga rrethanat e njohura botërisht ka braktisur Ferizajn dhe nuk ka mundur të jetë në marrëdhënie pune pasi që ka qenë i diskriminuar ngase është i nacionalitetit serb. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas braktisjes së qytetit të Ferizajt ka kontaktuar me udhëheqësit e ndërmarrjes për tu kthyer në punë por nga të njëjtit i është thënë se nuk mund të garantojnë për jetën e tij dhe të familjes andaj nuk ka pasur guxim që të vie pas lufte dhe të vazhdoj punën.

A0022 S. (R) Sh

Me 28 qershor 2016 **Ankuesi A0022 – S. (R) Sh**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se gjykatës i është prezantuar librezë e punës me nr. 6450/75 me datë të fillimit e cila është hapur me 10 janar 1977 dhe nga e cila vërtetohet se ka punuar deri në vitin 1999 pa ndërprerje në Ferizaj, po ashtu ankuesi ka pohuar se shumë punëtor nuk kanë mundur ti përcjellin shpalljet e privatizimit .

Ankesa te lartcekura i janë dorëzuar AKP-së me datë 06 gusht 2018 dhe e njëjta nuk ka parashtruar përgjigje.

Arsyetimi ligjor

Ne bazë të nenit 69.1 të Shtojcës së Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomës e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit , Kolegji i Apelit vendos që të heqë dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Meritat e ankesave dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Diskriminimi

Në mënyrë që të ndalojë diskriminimin, promovojë dhe të fusë në fuqi parimin e trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës, Kuvendi i Kosovës, më 30 korrik 2004, miratoi Ligjin Kundër Diskriminimit nr. 2004/3.

Sa i përket barrës së provave, neni 8 i Ligjit Kundër Diskriminimit, mbi barrën e provave, thotë si vijon:

8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

Sipas interpretimit të mësipërm, kur një ankues ka për qëllim të dëshmojë se është diskriminuar, nga ai/ajo kërkohet vetëm që të pretendojë faktet specifike nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim (të drejtpërdrejtë apo të tërthortë), dhe i mbetet të paditurit (në këtë rast Agjencisë) që të dëshmojë të

kundërtën, d.m.th. të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

Sipas të drejtës precedentale DHPGJS-së(ASC-11-0069, AC-I-12-0012 etj), të diskriminuar mund të llogariten:

- a) punëtorët e përkatësisë etnike shqiptare, apo që u takojnë minoriteteve ashkali, romë, egjiptian, goran dhe turq, të cilët ishin larguar për arsye diskriminimi në periudhën e ashtuquajtur të "masave të përkohshme serbe" (që sillet prej vitit 1989 deri në vitin 1999), apo të cilët u diskriminuan edhe në periudha të ndryshme, për shkak të etnisë së tyre, besimeve politike dhe religjioze, etj.;
- b) punëtorët e përkatësisë etnike serbe të cilët për shkak të mungesës së sigurisë pas vitit 1999, nuk u paraqiten në punë dhe të njëjtit nuk u gjendën në listat përfundimtare të punëtorëve.

Si pasojë e të ashtuquajturave "Masa të Përkohshme" të vëna në NSH, menaxhmenti shqiptar u largua dhe u zëvendësua me menaxhmentin serb (shih Ligji mbi Masat e Përkohshme për Mbrojtjen Shoqërore të të Drejtave Vetë-Menaxhuese dhe të Pronës Shoqërore, publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste të Serbisë nr. 49 të datës 28 tetor 1989, i vili ligj nuk është në fuqi sipas rregullores së UNMIK-ut 1999/24) një numër i punëtorëve që i takojnë minoritetit serbo-kosovar, punuan gjatë periudhës së masave të përkohshme serbe (1989-1999), por nuk ishin në gjendje që të kthehen në punë menjëherë pas luftës, pra duke u diskriminuar nga menaxhmenti i ri. Kur një ankues pretendon fakte specifike diskriminuese i mbetet të paditurit që të dëshmojë se ankuesi nuk është diskriminuar.

Për të gjitha arsyet e mësipërme ligjore, ankesa pranohet si e bazuar kur ankuesi dëshmon të ketë qenë i punësuar në NSH për së paku tri vite dhe ai është i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit ose kur ai ka dorëzuar prova se nuk ishte në gjendje të punojë sepse ishte diskriminuar, në të kundërtën ankesa

duhet si e pa bazuar kur faktet dhe rrethanat e lartpërmendura nuk janë vërtetuar nga ankuesi.

Në çështjen konkrete ankesa e AKP-së e ushtruar kundër pikës së -I- dhe të -V- të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar është pjesërisht e bazuar për disa punëtor dhe pjesërisht e pa bazuar për punëtorët që janë futur në listën përfundimtare, pasi që ankuesit të cilët janë futur në listën përfundimtare nga ana e Kolegjit të Specializuar kanë dëshmuar se kanë qenë punëtor të NSH-së dhe kanë pretenduar diskriminimin e largimit të tyre nga puna para dhe pas qershorit të vitit 1999.

Andaj për ankuesit të cilët janë futur në listën përfundimtare është i saktë përfundimi i Kolegjit të Specializuar dhe të njëjtit duhen të mbesin në listën përfundimtare pasi që i plotësojnë kushtet ligjore në bazë të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

Ne vazhdim jepen arsytet specifike ligjore për secilin ankues, të cilët duhet të mbeten në listën përfundimtare me të drejta legjitime dhe për ata të cilët duhet të hiqen nga lista përfundimtare me të drejta legjitime.

A0001 Y. Q

Me 18 maj 2016 **Ankuesi A0001 – Y. Q**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016. Ankuesi ka pohuar se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i pa qartë dhe kundërthënës me brendinë e vetë përkitazi me faktet vendimtare si dhe arsytet e prezantuara në arsyetimin e këtij aktgjykimi dhe përmbajtjes së shkresave të lëndës, po ashtu ankuesi ka pohuar se ekzistojnë të gjitha faktet dhe provat se ai ka qenë punëtor i NSH-së dhe se nuk ka ndonjë vendim të organit kompetent për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, e që ka pas për obligim kjo ndërmarrje në momentin e mbylljes së librezës së punës ti bie vendim mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës e këtë nuk e ka bërë. Ankuesi ka pohuar se është diskriminuar për shkak të mos realizimit të së drejtës së 20 % nga shitja e kësaj NSH-je. Si provë ka bashkangjitur kopjen e librezës së

punës, kopjen e vërtetimit mbi përvojën e punës dhe kopjen e listës përfundimtare të shpallur nga AKP-ja.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankues ka konstatuar se nga librezja e punës shihet që punëtori punën e ka filluar me datë 10 korrik 1971 deri më 30 tetor 1972 pastaj prej datës 08 nëntor 1973 deri më 16 mars 1995 pastaj prapë prej datës 01 gusht 1999 deri më 31 mars 2000 andaj gjykata vendos se provat e disponuara tregojnë se ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës, nuk është kontestuese se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune dhe ka qenë punëtor i NSH-së, Kolegji i Apelit vlerëson se ankuesi ka mundur ta plotësoj kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së, pasi që nga librezja e punës shihet që ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me NSh. dhe është larguar nga puna në kohën e instalimit të masave të nga Serbia. Prandaj i Kolegji i Apelit konsideron se i njëjti do të ishte në marrëdhënie pune sikur të mos ishte diskriminuar. Për herë të fundit në NSH nga data 01 gusht 1999 dhe të njëjtën marrëdhënie e ka të mbyllur me datë 31 mars 2000. Por ankuesi nuk është njoftuar asnjëherë nga NSh-ja se atij i është ndërpre marrëdhënia e punës . Në një situatë të tillë i njëjti mund të konsiderohet se ishte në marrëdhënie pune deri në ditën e privatizimit .

Andaj Kolegji i Apelit konsideron se i njëjti i plotësohen kriteret ligjore për tu përfshirë në listën përfundimtare me të drejta legjitime, kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin **Y.Q** të përshijë në listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " N", Ferizaj.

A0002 F. T

Me 18 maj 2016 **Ankuesi A0002 – F. T**, përmes të autorizuarit të tij Av. J. R, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016. Ankuesi ka pohuar se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i pa qartë dhe kundërthënës me brendinë e vetë përkitazi me faktet vendimtare si dhe arsyet e prezantuara në arsyetimin e këtij aktgjykimi dhe përmbajtjes së shkresave të lëndës, po ashtu ankuesi ka pohuar se një e drejtë e tillë i takon për vet faktin se ankuesi ka punuar për atë periodë kohore dhe i ka realizuar të drejtat për realizimin e 20 % nga shitja e kësaj NSH-je. Ankuesi ka pohuar se është diskriminuar për shkak të mos realizimit të së drejtës së 20 % nga shitja e kësaj NSH-je. Si provë ka bashkangjitur kopjen e librezës së punës, kopjen e vendimit të datës 19 gusht 2002, kopjen e letërnjoftimit dhe autorizimin për përfaqësim.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankues ka konstatuar se ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë materiale për të vërtetuar se ka qenë punëtor i NSH-së apo për të dëshmuar kontinuitetin e marrëdhënies së punës, andaj gjykata vendos se provat e disponuara tregojnë se ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, Kolegji i Apelit vlerëson se ankuesi në shkallë të parë ka pohuar se dokumentacioni gjendet në AKP si administruese e NSH-së dhe nuk ka parashtruar asnjë dëshmi për të vërtetuar faktet e pretenduara nga ana e tij. Ankuesi gjatë ushtrimit të ankesës në shkallë të dytë ka ofruar si provë kopjen e librezës së punës dhe kopjen e vendimit të datës 12 gusht 2002,

Kolegjit të Apelit konsideron se ankuesi ka shpresuar se Kolegji i Specializuar do të kërkojë dokumentacionin përkatës nga AKP-ja . Për më tepër Kolegji i Specializuar

nuk ka mbajtur as seancë degjimore në të cilën pala do të mund të deklarohej drejtpërdrejtë mbi faktet dhe provat e pretenduara.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit vendosi që të pranoj provat e parashtruar para kolegjit të Apelit.

Andaj Kolegji i Apelit konsideron se i njëjti i plotësohen kriteret ligjore për tu përfshirë në listën përfundimtare me të drejta legjitime, kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin Faik Terziu të përfshijë në listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " 17 Nëntori", Ferizaj.

A0003 N. Q

Me 18 maj 2016 **Ankuesi A0003– N. Q**, përmes të autorizuarit të tij Av. J. R, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016. Ankuesi ka pohuar se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i pa qartë dhe kundërthënës me brendinë e vetë përkitazi me faktet vendimtare si dhe arsyet e prezantuara në arsyetimin e këtij aktgjykimi dhe përmbajtjes së shkresave të lëndës, po ashtu ankuesi ka pohuar se një e drejtë e tillë i takon për vet faktin se ankuesi ka punuar për atë periodë kohore dhe i ka realizuar të drejtat për realizimin e 20 % nga shitja e kësaj NSH-je. Ankuesi ka pohuar se është diskriminuar për shkak të mos realizimit të së drejtës së 20 % nga shitja e kësaj NSH-je. Si provë ka bashkangjitur kopjet e vendimeve për lejimin e mungesës nga puna pa pagesë.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankues ka konstatuar se ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë materiale për të vërtetuar se ka qenë punëtor i NSH-së apo për të dëshmuar kontinuitetin e marrëdhënies së punës, andaj gjykata vendos që nga provat e disponuara tregojnë se ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, Kolegji i Apelit vlerëson se ankuesi në shkallë të parë ka e parashtruar vendimin për lejimin e mungesës nga puna pa pagesë.

Ankuesi gjatë ushtrimit të ankesës në shkallë të dytë ka ofruar si provë kopjen e librezës së punës dhe kopjen e vendimit të datës 12 gusht 2002.

Kolegjit të Apelit konsideron se ankuesi ka parashtruar një dokument i cili dëshmon ekzistimin e mardhënies së punës, vendimin për lejimin e mungesës nga puna pa pagesë.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit vendosi që të pranoj provat shtesë të parashtruar para kolegjit të Apelit.

Andaj Kolegji i Apelit konsideron se i njëjti i plotësohen kriteret ligjore për tu përfshirë në listën përfundimtare me të drejta legjitime, kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin Nazmi Qorolli të përfshijë në listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " 17 Nëntori", Ferizaj.

A0004 M. (R) B

Me 18 maj 2016 **Ankuesi A0004 – M. (R) B**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL-11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe çështja të kthehet në rigjykim. Ankuesi ka pohuar se mos mbyllja e librezës së punës ka si rrjedhojë neglizhencën e administratës me të cilën ka udhëhequr ish drejtori Q. B dhe si përgatitje e qëllimshme që disa punëtor të mbesin të regjistruar gjërë në kohën e privatizimit, po ashtu ankuesi i ka kontestuar disa punëtor që janë përfshirë në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se ka ushtruar ankesë për hire të drejtësisë dhe të vërtetës që provat të kërkohen në AKP nëpërmjet dokumentacionit në disponim, po ashtu ka pohuar se nuk është kundër punëtorëve legjitim që me të vërtetë iu takon kjo e drejtë por se

është kundër atyre dhe ndihmësve të tyre që në mënyrë korruptive mundësohen që të përfitojnë në dëm të punëtorëve të ndershëm.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankues ka konstatuar se ankuesi nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar pasi që ai ka hyrë në moshën për pension para datës së privatizimit të NSH-së.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës, nuk është kontestuese se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune dhe ka qenë punëtor i NSH-së, por Kolegji i Apelit vlerëson se ankuesi nuk ka mundur ta plotësoj kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së, pasi që nga librezja e punës shihet që ankuesi ka lindur me datë 10 dhjetor 1939, që do të thotë se ankuesi e ka arritur moshën e pensionimit para se ndërmarrja të privatizohet dhe kësaj nuk plotësohen kriteret ligjore për tu përfshirë në listën përfundimtare me të drejta legjitime. Sipas nenit 67.1.4 e Ligjit të Punës, nr. 03/L-212 punësimi përfundon kur punëtori e arrin moshën e pensionimit prej 65 vjetëve.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e pabazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor sa i përket këtij ankuesi vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

A0005 T. H

Me 18 maj 2016 **Ankuesi A0005 – T. H**, përmes të autorizuarit të tij Av. J. R, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016. Ankuesi ka pohuar se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i pa qartë dhe kundërthënës me brendinë e vetë përkitazi me faktet vendimtare si dhe arsyet e prezantuara në arsyetimin e këtij aktgjykimi dhe përmbajtjes së shkresave të

lëndës, po ashtu ankuesi ka pohuar se një e drejtë e tillë i takon për vet faktin se ankuesi ka punuar për atë periodë kohore dhe i ka realizuar të drejtat për realizimin e 20 % nga shitja e kësaj NSH-je. Ankuesi ka pohuar se është diskriminuar për shkak të mos realizimit të së drejtës së 20 % nga shitja e kësaj NSH-je. Si provë ka bashkangjitur aktvendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës pa pëlqimin e punëtorit, kopjen e vendimit të datës 19 gusht 1991, kopjen e raportit mbi konstatimin e gjendjes pas regjistrimit të njësisë afaristë në NSH, autorizimin për përfaqësim dhe vërtetimin lëshuar nga drejtori i NSH-së.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankues ka konstatuar se ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë materiale për të vërtetuar se ka qenë punëtor i NSH-së apo për të dëshmuar kontinuitetin e marrëdhënies së punës, andaj gjykata vendos që nga provat e disponuara tregojnë se ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës, nuk është kontestuese se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune dhe ka qenë punëtor i NSH-së, Kolegji i Apelit vlerëson se ankuesi ka mundur ta plotësoj kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së, pasi që nga librezat e punës shihet që ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me NSH. dhe është larguar nga puna në kohën e instalimit të masave të nga Serbia. Prandaj i Kolegji i Apelit konsideron se i njëjti do të ishte në marrëdhënie pune sikur të mos ishte diskriminuar. Në një situatë të tillë i njëjti mund të konsiderohet se ishte në marrëdhënie pune deri në ditën e privatizimit . Andaj Kolegji i Apelit konsideron se i njëjti i plotësohen kriteret ligjore për tu përfshirë në listën përfundimtare me të drejta legjitime, kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin Tahir Hasani të përshijë në listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " 17 Nëntori", Ferizaj.

A0006 H. (H) R

Me 18 maj 2016 **Ankuesi A0006 – H. (H) R**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se ka qenë punëtor i NSH-së plotë 43 vjet 5 muaj e 16 ditë se NSH-ja u krijua me kontributet e punëtorëve, po ashtu ankuesi ka pohuar se ka qenë punëtor i rregullt edhe tri vite pas hyrjes në fuqi të rregullores së UNMIK-ut. Ankuesi ka pohuar se po kërkon djersën e tij që ka derdhur, po ashtu pohon se punësimi përfundon por jo edhe borxhi.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankues ka konstatuar se ankuesi nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar pasi që ai ka hyrë në moshën për pension para datës së privatizimit të NSH-së.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës, nuk është kontestuese se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune dhe ka qenë punëtor i NSH-së, por Kolegji i Apelit vlerëson se ankuesi nuk ka mundur ta plotësoj kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së, pasi që nga librezja e punës shihet që ankuesi ka lindur me datë 03 maj 1938, që do të thotë se ankuesi e ka arritur moshën e pensionimit para se ndërmarrja të privatizohet dhe kështu nuk plotësohen kriteret ligjore për tu përfshirë në listën përfundimtare me të drejta legjitime. Sipas nenit 67.1.4 e Ligjit

të Punës, nr. 03/L-212 punësimi përfundon kur punëtori e arrin moshën e pensionimit prej 65 vjetëve.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e pabazuar dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor sa i përket këtij ankuesi vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

A0008 R. (S) J

Me 19 maj 2016 **Ankuesi A0008 – R. (S) J**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se ka qenë punëtor i NSH-së që nga data 07 shkurt 1973 e gjerë me 30 shtator 2006 dhe se në kohën e shpalljes së privatizimit të NSH-së ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune, deri në përfundimin e valës së parafundit kur edhe ka arrit kohën e pensionimit, po ashtu ankuesi ka pohuar se nuk është e vërtet se në kohën e privatizimit të ndërmarrjes ka qenë në moshën e pensionimit pasi që ka lindur me 1941 dhe në kohën e privatizimit ishte mbi moshën 65 vjeç, por pohon se ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune gjerë në valën e fundit të privatizimit të NSH-së siç dokumentojnë dhe argumentojnë regjistrat për pagesën e fitimeve që ja bashkëngjisim si provë.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankues ka konstatuar se ankuesi nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar pasi që ai ka hyrë në moshën për pension para datës së privatizimit të NSH-së.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës, nuk është kontestuese se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune dhe ka qenë punëtor i NSH-së, por Kolegji i Apelit vlerëson se ankuesi nuk ka mundur ta plotësoj kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në

listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së, pasi që nga librezja e punës shihet që ankuesi ka lindur me datë 19 shtator 1941, që do të thotë se ankuesi e ka arritur moshën e pensionimit para se ndërmarrja të privatizohet dhe kësaj nuk plotësohen kriteret ligjore për tu përfshirë në listën përfundimtare me të drejta legjitime. Sipas nenit 67.1.4 e Ligjit të Punës, nr. 03/L-212 punësimi përfundon kur punëtori e arrin moshën e pensionimit prej 65 vjetëve.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa është e pabazuar dhe rrjedhimisht aktgjykimi ankimor sa i përket këtij ankuesi vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

A0009 I. (A) R

Me 19 maj 2016 **Ankuesi A0009 – I. (A) R**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se nuk është marrë parasysh kontributi i tij dhe i punëtorëve tjerë që kanë ndarë për 40 vite, kanë krijuar këtë pasuri që është shitur për një copë bukë, sipas ankuesit gjykata ka pasur parasysh vetëm ligjin e punës ku ceket se punësimi përfundon kur punëtori arrin moshën e pensionimit prej 65 viteve por kjo nuk e ndalon që të kërkohen borxhet nga NSH-ja në qoftë se ajo ka ndonjë obligim.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankues ka konstatuar se ankuesi nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar pasi që ai ka hyrë në moshën për pension para datës së privatizimit të NSH-së.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës, nuk është kontestuese se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune dhe ka qenë punëtor i NSH-së, por Kolegji i Apelit vlerëson se ankuesi nuk ka mundur ta plotësojë kushtin e të qenit

në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së, pasi që nga librezja e punës shihet që ankuesi ka lindur në vitin 1939, që do të thotë se ankuesi e ka arritur moshën e pensionimit para se ndërmarrja të privatizohet dhe kësaj nuk plotësohen kriteret ligjore për tu përfshirë në listën përfundimtare me të drejta legjitime. Sipas nenit 67.1.4 e Ligjit të Punës, nr. 03/L-212 punësimi përfundon kur punëtori e arrin moshën e pensionimit prej 65 vjetëve.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e pabazuar dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor sa i përket këtij ankuesi vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

A0010 D. E

Me 19 maj 2016 **Ankuesi A0010 – D. E /1**, përmes të autorizuarit Av. M. H, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, për shkak të futjes në listën e pagave të punëtorëve nga numri rendor 1-55 si dhe numër C-044, me pretendimin se aktgjykimi ia takuar është nxjerrë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankuesit kanë pohuar se Kolegji i Specializuar e ka aprovuar pjesërisht ankesën e tyre, duke mos e aprovuar kërkesën për largimin e personave nga lista e përfituesve me numër C-32 1-55 si dhe C-44 edhe pse provat materiale ishin mjaft bindëse të cilat konfirmonin se personat e tillë ishin posedues të bizneseve dhe personat fizik dhe të cilët nuk disponojnë të drejta legjitime të inkuadrohen në listën e përfitimit të 20 % të aseteve të shitura të NSH-së. Si provë kanë bashkangjitur disa kontrata të qirasë mbi lokalet afariste, kopjen e regjistrit për pagesën e pagave mujoren, kopjen nga libri amzë dhe autorizimin për përfaqësim.

Ankesa e lartcekur i është dorëzuar përfaqësuesit të punëtorëve të kontestuar Av. K. A, me datë 26 shtator 2018 dhe i njëjti ka parashtruar përgjigje duke e kundërshtuar ankesën dhe duke pohuar se është e qartë se ankesa është tërësisht

e pabazë dhe e orientuar në drejtim të zvarritjes së këtij procesi, andaj edhe duhet të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Kolegji i Specializuar ankesën e ushtruar në shkallë të parë e ka aprovuar pjesërisht duke i lënë në listën përfundimtare punëtorët V. A, M. A, Q. B, S. B A. F, F. G, S. G, H. H, Rr. H, B. H, I. J, M. J, F. M, B. M, A. N, S. N, I. O, Xh. Q, H. R, B. R, I. Rr, I. S, H. Sh, F. S, R. H, A. R, H. A, S. T, M. V, Xh. Z, K. Z dhe Nj.Z, të cilët i kanë plotësuar kërkesat ligjore të parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar, për të mbetur në listën përfundimtare të punëtorëve. Kolegji i Specializuar ka arsyetuar për secilin ankues se pse duhet të mbesin në listën përfundimtare.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket kësaj ankuese është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Në aktgjykimin e atakuar Kolegji i Specializuar ka arsyetuar në masë të mjaftueshme për secilin ankues të cilët duhet të mbesin në listën përfundimtare të shpallur nga AKP-ja, pasi që i plotësojnë kriteret ligjore të parapara me nenin 10.4 të rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar dhe me një përfundim të tillë pajtohet edhe Kolegji i Apelit pasi që vlerëson se në bazë të dokumentacionit i cili gjendet në shkresat e lëndës, punëtorët e lartcekur i plotësojnë kriteret ligjore për të mbetur në listën përfundimtare.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e pabazuar dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor sa i përket këtyre ankuesve vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

A0011 S. S

Me 20 maj 2016 **Ankuesja A0011 – S. S**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e saj për futje në listën përfundimtare. Ankuesja ka pohuar se është e vërtet se ankesën e ka paraqitur pas kalimit të afatit por AKP-ja le ta vërtetoj se a e ka njoftuar ndonjëherë prej 19

nëntorit 2011 kur për herë të parë ka parashtruar ankesë dhe ta dëshmoj se në vendqëndrimin e saj kurrfarë shtypi ditor kosovar nuk arrin as në gjuhën serbe por as në gjuhën shqipe, po ashtu pohon se në gazetën zyrtare nuk ka qasje pasi që nuk është e moshës së re dhe nuk ka qasje në internet dhe ne faqet tjera elektronike. Ankuesja ka pohuar se që nga data 01 korrik 1992 e gjerë në qershor të vitit 1999 ka punuar në NSH dhe detyrat punuese i ka kryer me përgjegjësi të plotë dhe rezultate të larta në punë.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankuesë ka konstatuar se ankesa është e pa pranueshme sepse është parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket kësaj ankuesë është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga vula e pranimit të gjykatës vërtetohet fakti se ankesa është dorëzuar më datë 20 mars 2015, ndërsa në bazë të shpalljes së listës përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime nga AKP-ja, afati i fundit për paraqitjen e ankesave në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme ka qenë data 19 nëntor 2011, në rastin konkret, nga ana e ankueses nuk është respektuar afati për paraqitjen e ankesës, ashtu që ankesa është parashtruar me më shumë se tri vite vonesë, ndërsa arsyet e dhëna nga ankuesja për lëshimin e afatit, Kolegji i Apelit i vlerëson si të pa bazuara dhe pa ndikimin në vendosje ndryshe nga Kolegji i Specializuar.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e pabazuar dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor sa i përket kësaj ankuesë vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

A0012 J. S

Me 20 maj 2016 **Ankuesja A0012 – J. S, ,** ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e saj për futje në listën përfundimtare. Ankuesja ka pohuar se është e vërtet se ankesën e ka paraqitur pas

kalimit të afatit por AKP-ja le ta vërtetoj se a e ka njoftuar ndonjëherë prej 19 nëntorit 2011 kur për herë të parë ka parashtruar ankesë dhe ta dëshmoj se në vendqëndrimin e saj kurrfarë shtypi ditor kosovar nuk arrin as në gjuhën serbe por as në gjuhën shqipe, po ashtu pohon se në gazetën zyrtare nuk ka qasje pasi që nuk është e moshës së re dhe nuk ka qasje në internet dhe ne faqet tjera elektronike. Ankuesja ka pohuar se që nga data 08 shkurt 1988 e gjerë në qershor të vitit 1999 ka punuar në NSH dhe detyrat punuese i ka kryer me përgjegjësi të plotë dhe rezultate të larta në punë.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankuesë ka konstatuar se ankesa është e pa pranueshme sepse është parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket kësaj ankuesë është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga vula e pranimit të gjykatës vërtetohet fakti se ankesa është dorëzuar më datë 20 mars 2015, ndërsa në bazë të shpalljes së listës përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime nga AKP-ja, afati i fundit për paraqitjen e ankesave në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme ka qenë data 19 nëntor 2011, në rastin konkret, nga ana e ankueses nuk është respektuar afati për paraqitjen e ankesës, ashtu që ankesa është parashtruar me më shumë se tri vite vonesë, ndërsa arsyet e dhëna nga ankuesja për lëshimin e afatit, Kolegji i Apelit i vlerëson si të pa bazuara dhe pa ndikimin në vendosje ndryshe nga Kolegji i Specializuar.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e pabazuar dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor sa i përket kësaj ankuesë vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

A0013 B. S

Me 20 maj 2016 **Ankuesi A0013 – B. S**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën

përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se me aktgjykimin e atakuar është aprovuar ankesa e ankuesve për përjashtimin e tij nga lista përfundimtare ashtu që ankuesin si punëtor shumë vjeçar të ndërmarrjes e ka përjashtuar nga lista përfundimtare, po ashtu ankuesi pohon se Kolegjit të Apelit i ofron një mori dokumentesh të cilat vërtet flasin se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së dhe se i është ndërprerë marrëdhënia e punës siç shihet nga librezja e punës me 11 tetor 1995. Ankuesi ka pohuar se ndaj tij është ushtruar një lloj diskriminimi nga ana e drejtorit i cili përkundër punës ai nuk i ka bartë shënimet në regjistrat përkatës- në librezën e punës pasi që pretendon se edhe ankuesi ka punuar dhe i ka përjetuar sfidat e njëjta sikurse punëtorët tjerë të cilët kanë mbetur në listë. Si provë ka bashkangjitur kopjen e librezës së punës, vendimin e datës 13 nëntor 1985, kopjen nga libri amzë, vendimin e datës 01 qershor 1992 dhe kopjen e letërnjoftimit.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankues ka konstatuar se nga librezja e punës shihet se ankuesi punën e ka filluar me 13 maj 1985 deri më 11 tetor 1995 andaj gjykata ka vendosur se nga provat e disponuara ankuesi nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës, nuk është kontestuese se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune dhe ka qenë punëtor i NSH-së, Kolegji i Apelit vlerëson se ankuesi ka mundur ta plotësoj kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së, pasi që nga librezja e punës shihet që ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me NSH. dhe është larguar nga puna në kohën e instalimit të masave të nga Serbia. Prandaj i Kolegji i Apelit konsideron se i njëjti do të ishte në marrëdhënie pune sikur të mos ishte diskriminuar.

Andaj Kolegji i Apelit konsideron se i njëjti i plotësohen kriteret ligjore për tu përfshirë në listën përfundimtare me të drejta legjitime, kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin Bujar Sefedini të përfshijë në listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " N", Ferizaj.

A0014 S. R

Me 24 maj 2016 **Ankuesi A0014– S. R, përmes të autorizuarit Av. E. Sh,** ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se aktgjykimi është marrë mbi bazën e gabuar faktike pasi që në listën përfundimtare të AKP-së figuron S. R dhe një Sali Rexhepi e që në fakt është i njëjti person, mirëpo ankuesit emri i është regjistruar në ndërmarrjen " N" si dhe në listën e pagave si S. R ndërsa i njëjti në realitet e ka S. R kjo vërtetohet nga vërtetimi i lëshuar nga organet komunale, po ashtu ankuesi ka pohuar se S. R, Komuna e Ferizajt, me numër personal 1005021207 të lëshuar MPB e Republikës së Kosovës ka qenë furnizues i shitores dhe shitës i mallit, kjo dokumentohet nga kontrata e punës ndërsa S. R tjetër i cili figuron në listë ka qenë qiramarrës para vitit 2000. Sipas ankuesit, ai është larguar nga lista përfundimtare në sajë të një keqkuptimi apo gabimit në raport me personalitetin e ankuesit S. R. Si provë ka bashkangjitur kopjen e kontratës së punës të datës 01 shtator 1999, kopjen e librezës së punës, kopjen e listës përfundimtare të shpallur nga AKP-ja, kopjen e regjistrit mbi pagesën e pagave, vërtetimin e lëshuar nga organet komunale në Ferizaj, kopjen e njoftimit të pranuar nga AKP-ja dhe kopjen e letërnjoftimit.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankues ka konstatuar se nga libri amë i punëtorëve shihet se ankuesi punën e ka filluar më 01 tetor 1983 dhe e ka mbyllur më 01 shkurt 1985, mirëpo nuk ka ofruar prova për ri vazhdim të marrëdhënies së

punës në NSH andaj gjykata ka vendosur se nga provat e disponuara ankuesi nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është jo i drejtë dhe i pa bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kontrata e punës e datës 01 shtator 1999 dhe nga kopja e librezës së punës, vërtetohet fakti se ankuesi ka ri themeluar marrëdhënie pune në NSH-në " N" dhe atë nga data 01 shtator 1999 dhe të njëjtën e ka të mbyllur më datë 01 qershor 2007 dhe nga kjo Kolegji i Apelit vlerëson se ankuesi e ka plotësuar kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së, pasi që marrëdhënien e punës e ka të mbyllur në kohën e privatizimit të NSH-së, që do të thotë se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit të ndërmarrjes dhe kështu i plotëson kriteret ligjore për tu përfshirë në listën përfundimtare me të drejta legjitime.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor sa i përket këtij ankuesi ndryshohet, ankuesi **S. R** përfshihet në listën përfundimtare të punëtoreve me të drejta legjitime.

A0015 B. M

Me 24 maj 2016 **Ankuesi A0015– B. M, përmes të autorizuarit Av. E. Sh,** ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se ka qenë në marrëdhënie pune të pandërprerë deri në momentin e privatizimit të ndërmarrjes shoqërore "N" Ferizaj, mirëpo i njëjti është larguar nga lista duke iu manipuluar dokumentacioni i tij me qëllim që të përfitojë një B M tjetër, KK Shtime i cili ka qenë qiramarrës në ndërmarrjen shoqërore " N" dhe se në këto rrethana gjykata Supreme është lajthitur duke e lënë në listën e përfituesve B. M nga KK Shtime, ndërsa në fakt

përfitues do të duhej të ishte B. M nga KK Ferizaj i cili ka qenë punëtor i NSH-së dhe ka punuar më se 37 vite. Si provë ka bashkangjitur kopjen e letërnjoftimit, kopjen e njoftimit nxjerrë nga AKP-ja, kopjen e regjistrit për pagesën e pagave, kopjen e kontratës së punës dhe kopjen e librezës së punës.

Kolegji i Apelit vlerëson se kjo ankesë duhet të hedhet poshtë si e pa pranueshme, pasi që nga shkresat, përkatësisht nga lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime të shpallur nga AKP-ja, ankuesi B. M, KK Ferizaj gjendet në listën përfundimtare dhe i njëjti nuk është kundërshtuar nga ankuesit tjerë, andaj Kolegji i Apelit vlerëson se ky ankues nuk ka pasur interes juridik për të parashtruar këtë ankesë dhe tani për të vendosur në themel për të njëjtën, andaj edhe e njëjta hedhet poshtë si e pa pranueshme.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa duhet të hedhet poshtë si e pa pranueshme.

A0016 H. (L) XH

Me 25 maj 2016 **Ankuesi A0016– H. (L) Xh**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se nuk ka mundur ta ushtrojë ankesën në afatin e paraparë kohor pasi që e ka pasur nën të sëmurë, po ashtu ankuesi ka pohuar se është në gjendje të keqe ekonomike dhe për shkak parave nuk ka pas mundësi të bëjë ankesë tek juristi dhe se Agjencinë për ndihmë juridike nuk e ka marrë parasysh. Si prova ka bashkangjitur dokumentacionin mjekësor të nëse së tij për ta arsyetuar lëshimin e afatit.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankuese ka konstatuar se ankesa është e pa pranueshme sepse është parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket kësaj ankuese është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga vula e pranimit të gjykatës vërtetohet fakti se ankesa është dorëzuar më datë 23 nëntor 2011 përmes postës rekomande, ndërsa në bazë të shpalljes së listës përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime nga AKP-ja, afati i fundit për paraqitjen e ankesave në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme ka qenë data 19 nëntor 2011, në rastin konkret, nga ana e ankuesit nuk është respektuar afati për paraqitjen e ankesës, ndërsa arsyet e dhëna nga ankuesi për lëshimin e afatit, Kolegji i Apelit i vlerëson si të pa bazuara dhe pa ndikimin në vendosje ndryshe nga Kolegji i Specializuar, pasi që koha e trajtimeve mjekësore të familjarit të ankuesit nuk përkojnë me kohën e lëshimit të afatit.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e pabazuar dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor sa i përket këtij ankuesi vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

A0017 S. (M) N

Me 25 maj 2016 **Ankuesja A0017– S. (M) N**, (C-0053/1) **L. L**, (C-0053/2) **S. S**, (C-0053/3) **Z. M**, (C-0053/4) **B. P dhe M R**, përmes të autorizuarit të tyre AV. Dejan Vasic, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tyre për futje në listën përfundimtare. Përfaqësuesi i ankuesve ka pohuar se padia është refuzuar me arsyetimin se ankuesit e kishin ndërruar vendin e tyre të punës dhe pohon se këta katër persona janë zhvendosur nga Kosova në qershor të vitit 1999 dhe që aktualisht si persona të zhdukur jetojnë në Serbi, po ashtu përfaqësuesi i ankuesve ka pohuar se gjykata duhet të marrë parasysh faktin se 17 vjet nuk janë pak dhe këta njerëz duhej gjendeshin disi të mbijetonin, ata mund të kenë punuar herë pas here me punëdhënës të tjerë por nuk kanë ndërpre punësimin e tyre në NSH "N" nga Ferizaj, ndërsa sa i përket ankuesve B. P dhe M. R dokumentet e nevojshme do të dorëzohen në gjykatë sapo ato të dorëzohen nga ana e përfaqësuesve të tyre.

Kolegji i Specializuar sa i përket ankueses **S. (M) N**, ka konstatuar se ankuesja ka krijuar marrëdhënie të re punës prej datës 07 gusht 1996, andaj gjykata nga provat e ofruara nga ankuesi tregohet se ajo nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket kësaj ankuese është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesja ka krijuar marrëdhënie të re punë nga data 07 gusht 1996, andaj në bazë të këtij fakti, ankuesja S. (M) N nuk ka mundur ta plotësoj kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së dhe me këtë përfundimi të Kolegjit të Specializuar lidhur me këtë ankuese pajtohet edhe Kolegji i Apelit .

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se sa i përket ankueses së lartcekur, Ankesa është e pabazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Kolegji i Specializuar sa i përket ankuesit **L. L**, ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie të re punës prej datës 01 shtator 2003, andaj gjykata nga provat e ofruara nga ankuesi tregohet se ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është jo i drejtë dhe i pa bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie punë në NSH nga data 16 shtator 1997 dhe librezë e punës është e hapur, ndërsa nuk qëndron konstatimi i Kolegjit të Specializuar se ankuesi ka

krijuar marrëdhënie të re pune, pasi që regjistrimi në entin për punë sociale siç është në rastin konkret nuk është dhe nuk konsiderohet punësim i ri. Po ashtu në deklaratën e dhënë nga ankuesi në shkallë të parë, e cila gjendet si provë në shkresat e lendes, ka pohuar se është larguar nga vendi i punës për shkak të situatës së krijuar dhe se pas luftës ka kontaktuar menaxhmentin e ri të ndërmarrjes nga të cilët nuk ka marrë përgjigje, andaj nga të lartcekurat konsiderohet se ankuesi i plotëson kriteret nga neni 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut për tu përfshirë në listën përfundimtare, pasi që ankuesi pas përfundimit të luftës nuk ka mundur ta vazhdoj marrëdhënien e punës për shkak të pasigurisë dhe konsiderohet se ka qenë i diskriminuar, deri te ky përfundim Kolegji i Apelit vie edhe për faktin se e paditura me asnjë provë nuk e dëshmon faktin se ankuesit ia ka ndërprere marrëdhënien e punës, apo se i njëjti nuk i është nënshtruar kushteve jo të barabarta-diskriminimit sa i përket vazhdimin të marrëdhënies së punës.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se sa i përket ankuesit të lartcekur, Ankesa është e bazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor sa i përket ankuesit **L. L ndryshohet**, i njëjti përfshihet në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime.

Kolegji i Specializuar sa i përket ankueses **S. S**, ka konstatuar se ankuesja nuk ka ofruar asnjë provë materiale për të vërtetuar se ka qenë punëtore e NSH-së apo për të dëshmuar kontinuitetin e marrëdhënies së punës, andaj gjykata vendos se ankuesja nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket kësaj ankuese është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, Kolegji i Apelit vërteton faktin e konstatuar nga Kolegji i Specializuar se ankuesja përveç deklaratës së dhënë nuk ka bashkangjitur asnjë provë me të cilat do të dëshmonte pretendimet e saj dhe do të vërtetonte faktin se ankuesja ka krijuar marrëdhënie pune në NSH " N" Ferizaj apo se ka qenë punëtore e kësaj ndërmarrje, ankuesja ka dështuar që ti ofrojë këto prova edhe gjatë

ushtrimit të ankesës në shkallë të dyte përmes të autorizuarit të saj, andaj nga të lartcekurat Kolegji i Apelit vlerëson se kjo ankuese nuk i plotëson kriteret ligjore të parapare me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar për tu përfshirë në listën përfundimtare me të drejta legjitime.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se sa i përket ankueses së lartcekur, Ankesa është e pabazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Kolegji i Specializuar sa i përket ankuesit **Z. M**, ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie të re pune, andaj gjykata vendos se ankuesi nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie të re punë nga data 03 maj 2004 deri me 30 qershor 2004, andaj në bazë të këtij fakti, ankuesi konsiderohet se duke krijuar marrëdhënie të re pune e ka ndërprerë marrëdhënien e mëparshme edhe pse librezë e punës është e hapur dhe kësaj nuk mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që nuk e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se sa i përket ankuesit të lartcekur, Ankesa është e pabazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Sa i përket ankuesve **B. P dhe M R**, Kolegji i Apelit konstaton se të njëjtit nuk kanë parashtruar ankesë dhe nuk kanë qenë palë në shkallë të parë, si dhe gjatë

ushtrimit të ankesës në shkallë të dytë Av. D. V nuk ka bashkangjitur autorizimin për përfaqësim apo ndonjë provë tjetër relevante lidhur me këta ankues, andaj edhe ankesa sa i përket ankuesve B. P dhe M. R hedhet poshtë si e pa pranueshme.

A0018 R. A

Me 26 maj 2016 **Ankuesit A0016– R. A (C-0032/1), përmes të autorizuarit Av. K. A,** kanë parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tyre për futje në listën përfundimtare si dhe të obligohet pala që ka bërë kundërshtimin ti paguaj shpenzimet e përfaqësimit sipas tarifës së OAK.

Ankuesi **R. A** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase ky ankues më datë 05 prill 2000 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist, kjo vërtetohet edhe me faktin se marrëdhënia e tij e punës nuk është e mbyllur në librin amë të ndërmarrjes e po ashtu nga se i njëjti ka punuar deri në ditën e privatizimit vërtetohet edhe me vërtetimin e lëshuar nga AKP-ja. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren në fuqi. Si provë ka bashkangjitur letër konfirmimin nga AKP-ja të datës 12 maj 2016.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se nga librezat e punës së punëtorit shihet se punën e ka filluar me datë 08 janar 1981 deri më 05 janar 1983 pastaj prej datës 12 dhjetor 1983 deri më 11 tetor 1995, pastaj prapë prej datës 01 korrik 1999 deri më 31 mars 2000, andaj gjykata ka vendosur se nga

provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesi ishte punëtor i NSh-së ndërsa konfirmimi i AKP-së nr. 24826/16 i datës 12/5/2016 vërteton se ai ishte punëtor i NSh-së deri ne ditën e privatizimit dhe kësaj mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e përfshirjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin R. A të përshijë ne listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " N", Ferizaj.

Ankuesi **Sh. H (C-0032/4)**, ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase në vitin 1994 punëtori është larguar në mënyrë diskriminuese nga vendi i tij i punës dhe pas këtij largimi ai ka punuar në një ndërmarrje private për të mbetur gjallë, po të mos ishte diskriminuar ky punëtor do të ishte i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes, po ashtu ankuesi ka pohuar se më datë 01 dhjetor 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist, kjo vërtetohet edhe me faktin se marrëdhënia e tij e punës nuk është e mbyllur në librin amë të ndërmarrjes e po ashtu nga se i njëjti ka punuar deri në ditën e privatizimit vërtetohet edhe me vërtetimin e lëshuar nga AKP-ja. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj

duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren në fuqi.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie të re pune prej datës 11 nëntor 1996, librezja e punës është e hapur, po shtu në librezën e punës data e fillimit të punës në NSH "17 Nëntori" është 10 dhjetor 1975 dhe librezja e punës është e mbyllur me 15 dhjetor 1994, andaj gjykata ka vendosur se nga provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se e paditura asnjëherë nuk i ka ndërpre marrëdhënien e punës kjo vërteton faktin se ai ishte punëtor i NSH-së deri në ditën e privatizimit dhe kësaj mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e përfshirjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin Shefqet Haliti të përshijë në listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " 17 Nëntori", Ferizaj.

Ankuesi **H. H (C-0032/5)**, a pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase ky ankues më datë 19 maj 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalitetin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë

e lokalit afarist, marrëdhënia e punës nuk është e mbyllur në librin amë të ndërmarrjes. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkalles së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi. Si provë ka bashkangjitur letër konfirmimin nga AKP-ja të datës 12 maj 2016.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se nga librezja e punës së punëtorit shihet se punën e ka filluar me datë 01 janar 1977 deri më 11 tetor 1991 pastaj prej datës 01 korrik 1999 deri më 31 mars 2000, andaj gjykata ka vendosur se nga provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se e paditura asnjëherë nuk i ka ndërpre marrëdhënien e punës kjo vërteton faktin se ai ishte punëtor i NSH-së deri ne ditën e privatizimit dhe kësisoj mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e përfshirjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin të përshijë ne listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " 17 Nëntori", Ferizaj.

Ankuesi **K. B (C-0032/6)**, ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase në vitin 1995 punëtori është larguar në mënyrë diskriminuese nga vendi i tij i punës dhe po të mos diskriminohej ende do të figuronte si punëtor i NSH-së, po ashtu ky punëtor ka punuar më shumë se tri vite për këtë ndërmarrje andaj ky punëtor i plotëson kushtet që të përfshihet në listën përfundimtare.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me datë 02 dhjetor 1980 deri më 11 tetor 1995, andaj gjykata ka vendosur se nga provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se i njëjti është larguar nga puna më 1995 në kohën e vendosjes së masave të dhunshme .

Kolegji i Apelit konsideron se sikur i njëjti të mos ishte larguar nga puna për shkak të diskriminimit do të ishte në marrëdhënie pune deri ditën e privatizimit dhe kështu mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e përfshirjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin **K. B** të përshijë në listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " N", Ferizaj.

Ankuesi **D. H (C-0032/9)**, ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase në vitin 1995 punëtori është larguar në mënyrë diskriminuese nga vendi i tij i punës dhe po të mos diskriminohej ende do të figuronte si punëtor i NSH-së, po ashtu ky punëtor ka punuar më shumë se tri

vite për këtë ndërmarrje andaj ky punëtor i plotëson kushtet që të përfshihet në listën përfundimtare.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me datë 03 mars 1990 deri më 11 tetor 1995, andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është jo i drejtë dhe i pa bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie punën në ndërmarrje më datë 03 mars 1990 deri më datë 11 tetor 1995, po ashtu në shkresat e lëndës gjendet edhe vërtetimi i datës 26 dhjetor 2002 i lëshuar nga drejtori i NSH-së në bazë të të vërtetohet fakti se ankuesi ka vazhduar marrëdhënien e punës pas përfundimit të luftës si dhe pohohet se ankuesi është larguar nga puna në vitin 1995 nga masat e dhunshme të instaluar në ndërmarrje, andaj në bazë të këtyre fakteve vërtetohet se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit të NSH-së dhe kësaj e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se sa i përket ankuesit të lartcekur, Ankesa është e bazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor ndryshohet, ashtu që ankuesi **D. H** përfshihet në listën përfundimtare me të drejta legjitime.

Ankuesi **Sh. F (C-0032/11)**, ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase ky ankues më datë 01 dhjetor 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që

punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren në fuqi.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me datë 27 qershor 1971 deri më 11 tetor 1995, pastaj prej 01 korrik 1999 deri më 31 maj 2001 dhe përsëri prej datës 01 qershor 2001 deri më 01 shkurt 2003, andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie punën në ndërmarrje për herë të fundit më datë 01 qershor 2001 deri më datë 01 shkurt 2003 dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi tjetër për të vërtetuar faktin se ankuesi ka vazhduar marrëdhënien e punës pas datës 01 shkurt 2003, andaj në bazë të këtij fakti, ankuesi e ka përfunduar marrëdhënien e punës para privatizimit të NSH-së dhe kështu nuk mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që nuk e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se sa i përket ankuesit të lartcekur, Ankesa është e pabazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se sa i përket ankuesit të lartcekur, Ankesa është e pabazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Ankuesja **N. I (C-0032/17)**, ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase kjo ankuese më datë 03 qershor 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist. Po ashtu ankuesja ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren në fuqi. Si provë ka bashkangjitur letër konfirmimin nga AKP-ja të datës 12 maj 2016.

Kolegji i Specializuar sa i përket kësaj ankuese ka konstatuar se ankuesja ka krijuar marrëdhënie pune me datë 06 shkurt 1975 deri më 18 prill 1996, pastaj prej 01 korrik 1999 deri më 01 prill 2000, andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket kësaj ankuese është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesja ka krijuar marrëdhënie punën në ndërmarrje për herë të fundit më datë 01 korrik 1999 deri më datë 01 prill 2000 dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi tjetër për të vërtetuar faktin se ankuesja ka vazhduar marrëdhënien e punës pas datës 01 shkurt 2003, andaj në bazë të këtij fakti, ankuesja e ka përfunduar marrëdhënien e punës para

privatizimit të NSH-së dhe kësaj nuk mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që nuk e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se sa i përket ankueses së lartcekur, Ankesa është e pabazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Ankuesi **J. K (C-0032/20)**, ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase ky ankues më datë 14 tetor 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne , andaj duke pas parasysh se punëtori ka themeluar marrëdhënie pune në ndërmarrje menjëherë pas lufte dhe se kontrata për qiranë ka paraparë që pasi të përfundoj ai do të kthehet në punë dhe ashtu ka ndodhur.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me datë 01 shtator 1966 deri më 27 prill 1967, pastaj prej 23 shtator 1968 deri më 30 korrik 1981 dhe përsëri prej datës 01 dhjetor 1981 deri më 16 tetor 1992 si dhe prej datës 01 korrik 1999 deri më 01 korrik 2003, andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesi ka krijuar

marrëdhënie punën në ndërmarrje për herë të fundit më datë 01 korrik 1999 deri më datë 01 korrik 2003 dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi tjetër për të vërtetuar faktin se ankuesi ka vazhduar marrëdhënien e punës pas datës 01 korrik 2003, andaj në bazë të këtij fakti, ankuesi e ka përfunduar marrëdhënien e punës para privatizimit të NSH-së dhe kësaj nuk mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që nuk e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 nën 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së. Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se sa i përket ankuesit të lartcekur, Ankesa është e pabazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Ankuesi **S. M (C-0032/24)**, ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase ky ankues më datë 22 maj 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren në fuqi.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me datë 21 tetor 1983 deri më 07 mars 1994, pastaj prej 01 korrik 1999 deri më 31 mars 2000, andaj gjykata ka vendosur se nga provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie punën në ndërmarrje për herë të fundit më datë 01 korrik 1999 deri më datë 31 mars 2000 dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi tjetër për të vërtetuar faktin se ankuesi ka vazhduar marrëdhënien e punës pas datës 31 mars 2000, andaj në bazë të këtij fakti, ankuesi e ka përfunduar marrëdhënien e punës para privatizimit të NSH-së dhe kështu nuk mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që nuk e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se sa i përket ankuesit të lartcekur, Ankesa është e pabazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Ankuesi **D. P(C-0032/28)**, ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase ky ankues më datë 05 qershor 2000 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren në fuqi, kjo vërtetohet edhe nga libri amë i cili nuk është i mbyllur. Si provë ka bashkangjitur dy deklarata të dhënë nën betim dhe një shkresë të datës 16 maj 2000.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me datë 10 janar 1977 deri më 11 tetor 1995, pastaj prej 12 tetor 1995 deri më 10 qershor 2000, andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie punën në ndërmarrje për herë të fundit më datë 12 tetor 1995 deri më 10 qershor 2000 dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi tjetër për të vërtetuar faktin se ankuesi ka vazhduar marrëdhënien e punës pas datës 10 qershor 2000, andaj në bazë të këtij fakti, ankuesi e ka përfunduar marrëdhënien e punës para privatizimit të NSH-së dhe kështu nuk mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që nuk e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se sa i përket ankuesit të lartcekur, Ankesa është e pabazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Ankuesi **Y. Q (C-0032/30),**

Sa i përket ankuesit Y. Q, Kolegji i Apelit ka vendosur dhe arsyetuar tek ankesa **A0001** të po këtij aktgjykimi.

Ankuesi **H. R (C-0032/32),** ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike dhe faktin se në vitin 1994 punëtori është larguar nga puna në rrethana diskriminuese dhe po të mos ishte larguar nga puna në këto

rrethana ai ende do të ishte i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes, po ashtu ankuesi ka pohuar se më datë 08 mars 2001 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkalles së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se punëtori ka krijuar marrëdhënie të re pune prej datë 01 shkurt 1996 deri më datë 24 prill 1996, ka punuar në një ndërmarrje tjetër mirëpo nuk ka ofruar prova për ri vazhdim të marrëdhënies së punës në NSH-në në fjalë, andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se i njëjti është larguar nga puna më 1994 në kohën e vendosjes së masave të dhunshme .

Kolegji i Apelit konsideron se sikur i njëjti të mos ishte larguar nga puna për shkak të diskriminimit do të ishte në marrëdhënie pune deri ditën e privatizimit dhe kështu mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e

drejta e përfshirjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin H. R të përshijë ne listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " N", Ferizaj.

Ankuesja **M. R (C-0032/34)**, ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike ngase kjo ankuese më datë 01 prill 2001 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe se pas përfundimit të saj mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Po ashtu ankuesja ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren ne fuqi.

Kolegji i Specializuar sa i përket kësaj ankuese ka konstatuar se ankuesja ka krijuar marrëdhënie pune me datë 19 janar 1981 deri më 11 tetor 1995, pastaj prej 21 qershor 1999 deri më 30 mars 2000 , andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ajo nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket kësaj ankuesenuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se e njëjta është larguar nga puna më 1995 ne kohen e vendosjes së masave të dhunshme .

Kolegji i Apelit konsideron se sikur e njëjta sikur të mos ishte larguar nga puna për shkak të diskriminimit do të ishte në marrëdhënie pune deri ditën e privatizimit dhe kësaj mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e përfshirjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin **K. B** të përshijë në listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " N", Ferizaj.

Ankuesi **B. S (C-0032/37)**,

Sa i përket ankuesit **B. S**, Kolegji i Apelit ka vendosur dhe arsyetuar tek ankesa **A0013** të po këtij aktgjykimi.

Ankuesi **Sh. S (C-0032/38)**, ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike dhe faktin se në vitin 1995 punëtori është larguar nga puna në rrethana diskriminuese dhe po të mos ishte larguar nga puna në këto rrethana ai ende do të ishte i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes, po ashtu ankuesi ka pohuar se më datë 18 shtator 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren në fuqi.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me datë 22 korrik 1977 deri më 11 qershor 1978 pastaj prej 18 shtatorit 1979 deri më 11 tetor 1995, andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se i njëjti është larguar nga puna më 1995 në kohën e vendosjes së masave të dhunshme .

Kolegji i Apelit konsideron se sikur i njëjti sikur të mos ishte larguar nga puna për shkak të diskriminimit do të ishte në marrëdhënie pune deri ditën e privatizimit dhe kështu mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e përfshirjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin Sh. S të përfshijë në listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " N", Ferizaj.

Ankuesi **S. Sh (C-0032/40)**, ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike, për faktin se ankuesi më datë 08 shtator 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalit afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të

gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren në fuqi.

Kolegji i Specializuar sa i përket kësaj ankuese ka konstatuar se ankuesja ka krijuar marrëdhënie pune me datë 18 prill 1981 deri më 11 tetor 1995, pastaj prej 01 korrik 1999 deri më 15 maj 2000 , andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket kësaj ankuese është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesja ka krijuar marrëdhënie punën në ndërmarrje për herë të fundit më datë 01 korrik 1999 deri më 15 maj 2000 dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi tjetër për të vërtetuar faktin se ankuesi ka vazhduar marrëdhënien e punës pas datës 15 maj 2000, andaj në bazë të këtij fakti, ankuesja e ka përfunduar marrëdhënien e punës para privatizimit të NSH-së dhe kështu nuk mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që nuk e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se sa i përket ankueses të lartcekur, Ankesa është e pabazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Ankuesi **H. Sh (C-0032/41)**, ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike për faktin se ankuesi më datë 21 qershor 2002 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj

kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren në fuqi.

Kolegji i Specializuar sa i përket kësaj ankuese ka konstatuar se ankuesja ka krijuar marrëdhënie pune me datë 10 janar 1972 deri më 30 qershor 2002, andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket kësaj ankuese është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesja ka krijuar marrëdhënie punën në ndërmarrje më datë 10 janar 1972 deri më 30 qershor 2002 dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi tjetër për të vërtetuar faktin se ankuesi ka vazhduar marrëdhënien e punës pas datës 30 qershor 2000, andaj në bazë të këtij fakti, ankuesja e ka përfunduar marrëdhënien e punës para privatizimit të NSH-së dhe kështoj nuk mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që nuk e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se sa i përket ankueses të lartcekur, Ankesa është e pabazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Ankuesi **N. Sh (C-0032/42)**, ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike për faktin se punëtori në vitin 1995 punëtori është larguar nga puna në rrethana diskriminuese dhe po të mos ishte larguar nga puna në këto rrethana ai ende do të ishte regjistruar si punëtor i NSH-së.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie të re pune prej datës 01 tetor 1996 deri më 14 tetor 1997 ka punuar në Hakotrade mirëpo nuk ka ofruar prova për ri vazhdim të marrëdhënies së punës në NSH në fjalë, gjykata gjen se në kopjen e librezës së punës data e fillimit në NSH-në është 05 janar 1984 dhe librezja e punës është e mbyllur me 17 tetor 1995, andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se i njëjti është larguar nga puna më 1995 në kohën e vendosjes së masave të dhunshme .

Kolegji i Apelit konsideron se sikur i njëjti sikur të mos ishte larguar nga puna për shkak të diskriminimit do të ishte në marrëdhënie pune deri ditën e privatizimit dhe kështu mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e përfshirjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin N. Sh të përfshijë në listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " N", Ferizaj.

Ankuesi **Sh. S (C-0032/43)**, ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike për faktin se ndërprerja e marrëdhënies së punës në vitin 1993 është bërë në baza diskriminuese nga ish menaxhmenti serb ashtu siç

ka ndodhur me shumicën dërmuese të punëtorëve shqiptar, po ashtu ankues ka pohuar se do të ishte i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes po të mos ishte diskriminuar dhe se ankuesi i ka përfshirë të gjitha kriteret për përfshirje në listën përfundimtare.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie të re pune prej datës 01 tetor 1988 deri më 29 tetor 1993, mirëpo nuk ka ofruar prova për ri vazhdim të marrëdhënies së punës, andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se i njëjti është larguar nga puna më 1993 në kohën e vendosjes së masave të dhunshme .

Kolegji i Apelit konsideron se sikur i njëjti sikur të mos ishte larguar nga puna për shkak të diskriminimit do të ishte në marrëdhënie pune deri ditën e privatizimit dhe kështu mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e përfshirjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin **Sh. S** të përshijë në listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " N", Ferizaj.

Ankuesi **B. S (C-0032/44)**, ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike për faktin se ndërprerja e marrëdhënies së punës në vitin 1991 është bërë në baza diskriminuese nga ish menaxhmenti serb ashtu siç ka ndodhur me shumicën dërmuese të punëtorëve shqiptar, po ashtu ankues ka

pohuar se më datë 01 korrik 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkalles së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren në fuqi.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie të re pune prej datës 25 korrik 1972 deri më 12 shtator 1974 pastaj prej datës 15 shtator 1975 deri më 14 korrik 1995, mirëpo nuk ka ofruar prova për ri vazhdim të marrëdhënies së punës, andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se i njëjti është larguar nga puna më 1995 në kohën e vendosjes së masave të dhunshme .

Kolegji i Apelit konsideron se sikur i njëjti të mos ishte larguar nga puna për shkak të diskriminimit do të ishte në marrëdhënie pune deri ditën e privatizimit dhe kështu mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e përfshirjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin B. S të përshijë në listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " N", Ferizaj.

Ankuesi **S. H (C-0032/47)**, ka pohuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike për faktin se ndërprerja e marrëdhënies së punës në vitin 1995 është bërë në baza diskriminuese nga ish menaxhmenti serb ashtu siç ka ndodhur me shumicën dërmuese të punëtorëve shqiptar, po ashtu ankues ka pohuar se më datë 01 korrik 2003 ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist, në këtë kontratë është paraparë që punëtori nuk e humb marrëdhënien e punës me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate për qiranë e lokalit afarist dhe pas përfundimit të saj punëtori mund të kthehet në marrëdhënie pune me ndërmarrjen. Ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren në fuqi.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune prej datës 01 nëntor 1988 deri më 15 shtator 1991, mirëpo nuk ka ofruar prova për ri vazhdim të marrëdhënies së punës, andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se i njëjti është larguar nga puna më 1995 në kohën e vendosjes së masave të dhunshme .

Kolegji i Apelit konsideron se sikur i njëjti të mos ishte larguar nga puna për shkak të diskriminimit do të ishte në marrëdhënie pune deri ditën e privatizimit dhe kështu mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 nëni 10.4, për të ju njohur e drejta e përfshirjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin S. H të përshijë në listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " N", Ferizaj.

Ankuesi **K. V (C-0032/52)**, ka pohuar se ka themeluar marrëdhënie pune në ndërmarrje më datë 10 janar 1977 dhe ka punuar deri me 11 tetor 1995 kur edhe është larguar në mënyrë diskriminuese nga vendi i tij i punës, po ashtu ankues ka pohuar se ka lidhur kontratë qiraje për lokalin afarist dhe në bazë të kësaj kontrate ai e ka ruajtur marrëdhënien e punës në ndërmarrje. Ankuesi ka pohuar se pas përfundimit të luftës me 1999 shumë nga lokalet afariste të kësaj NSH-je janë marrë me qira nga vet punëtorët e ndërmarrjes përmes konkurseve interne andaj duke pas parasysh se gjykata e shkalles së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ngase punëtori në momentin e privatizimit të NSH-së ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes si dhe ka pasur me tepër se tri vite punë në ndërmarrje, ai ka plotësuar gjithë kriteret që parashihen me rregulloren në fuqi.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune prej datës 10 janar 1977 deri më 11 tetor 1995, pastaj prapë prej datës 01 korrik 1999 deri më 31 maj 2000, mirëpo nuk ka ofruar prova për ri vazhdim të marrëdhënies së punës, andaj gjykata ka vendosur se provat e

disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie punën në NSH "N" për herë të fundit më datë 01 korrik 1999 deri më 31 maj 2000, ndërsa para Kolegjit të Specializuar nuk ka pretenduar se ka qenë i diskriminuar kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës në vitin 1995, andaj në bazë të këtyre fakteve ankuesi e ka përfunduar marrëdhënien e punës në NSH "17 Nëntori" para privatizimit të NSH-së si dhe ankuesi nuk ka qenë punëtor në kohën e privatizimit të NSH-së dhe kësaj nuk mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që nuk e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së. Po ashtu ankuesi në ankesën e ushtruar në shkallë të dytë ka pohuar se ka qenë i diskriminuar kur është larguar nga puna, por të njëjtin pretendim nuk e ka paraqitur pranë Kolegjit të Specializuar kur i është drejtuar gjykatës me parashtresën e datës 14 nëntor 2013, andaj pretendimi i diskriminimit nuk mund të merret për bazë nga ana e shkallës së dytë përderisa një pretendim i tillë nuk është pohuar në shkallë të parë si dhe ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë rrethanë se pse nuk ka deklaruar se ka qenë i diskriminuar kur i ka paraqitur pretendimet e tij pranë shkallës së parë.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se sa i përket ankuesit të lartcekur, Ankesa është e pabazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Ankuesi **S. R(C-0032/56)**,

Sa i përket ankuesit Sali Rexhepi Kolegji i Apelit ka vendosur dhe arsyetuar tek ankesa **A0014** të po këtij aktgjykimi.

Ankuesja **S. H (C-0036)**, ka pohuar se ka filluar punën në NSH me datë 13 maj 1985 dhe ka punuar deri më datë 11 tetor 1995 kur është përjashtuar në mënyrë diskriminuese nga vendi i punës për shkak të etnisë së saj, dihet se gjatë viteve të nëntëdhjeta kemi pasur dëbime masive të punëtorëve shqiptar nga vendet e tyre të punës, ky është fakt notar andaj ankuesja pohon se po të mos ishte diskriminuar do të ishte regjistruar si punëtore e ndërmarrjes dhe se pas përfundimit të luftës ka qenë në pritje për të filluar marrëdhënien e punës por për shkak të mungesës së fondeve asnjëherë nuk është inkuadruar.

Kolegji i Specializuar sa i përket kësaj ankuese ka konstatuar se e njëjta nuk ka ofruar asnjë provë materiale për të vërtetuar se ka qenë punëtor i NSH-së apo për të dëshmuar kontinuitetin e marrëdhënies së punës pas datës 11 tetor 1995, andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket kësaj ankuese është jo i drejtë dhe i pa bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesja ka krijuar marrëdhënie pune dhe ka qenë punëtore e NSH-së nga data 13 maj 1985 deri më 11 tetor 1995 për të cilën kohë ankuesja pretendon se i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga masat e dhunshme, po ashtu ankuesja pohon se pas përfundimit të luftës është paraqitur në vendin e saj të punës, andaj në bazë të këtyre fakteve Kolegji i Apelit vlerëson se koha kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës ankuseses ka qenë kohë kur punëtorja i është nënshtruar diskriminimit për shkak të përkatësisë etnike që ka, ndërsa pas përfundimit të luftës e njëjta është paraqitur në vendin e saj të punës i cili fakt vërtetohet nga vërtetimi i datës 16 janar 2001 dhe deklarata e datës 17 nëntor 2011, andaj konsiderohet se ankuesja

ka qenë punëtore në kohën e privatizimit të NSH-së dhe kësaj mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se sa i përket ankueses së lartcekur, Ankesa është e bazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor ndryshohet, ankuesja **S. H** futet në listën përfundimtare me të drejta legjitime.

A0019 V. (D) D

Me 30 maj 2016 **Ankuesi A0019 – V. (D) D**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCCL11-0057, të datës 18 prill 2016, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se nevoja e gjetjes së ndonjë punësimi të përkohshëm ishte e dukshme për të siguruar ekzistencën e familjes, po ashtu ankuesi ka pohuar se punësimin nuk e ka filluar me vullnetin e tij të lirë por kjo ishte shtyrë nga forca madhore dhe nuk e ka ditur që punësimi i përkohshëm diku tjetër mund të ishte arsye për përjashtim nga lista e punëtorëve me të drejta legjitime. Ankuesi ka pohuar se ishte njëherë i diskriminuar sepse është detyruar ta lëshoj vendin e punës dhe qytetin e tij dhe se refuzimi i ankesës për shkak të vonësës për të cilën pretendon se nuk ka faj do të nënkuptonte diskriminimin e përsëritur.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie të re të punës prej datës 19 korrik 2004, andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie punën në NSH " N" më datë 14 nëntor 1989 ndërsa librezën e punës e ka ende të hapur, po ashtu nga librezja e punës vërtetohet fakti se ankuesi nga data 19 korrik 2004 ka krijuar marrëdhënie të re pune në një ndërmarrje tjetër.

Andaj në bazë të këtyre fakteve ankuesi ka mundur të jetë punëtor i NSH "17 Nëntori" në kohën e privatizimit të NSH-së dhe kështu mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e përfshirjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së. (shif arsyetimin ligjor, diskrimini).

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtoreshën **V. (D) D** të përshijë në listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " N", Ferizaj.

A0020 D. (Milan) S

Me 31 maj 2016 **Ankuesi A0020 – D.(M) S**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 182.2 nen pika n e LPK-së, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike nga neni 183.1 të LPK-së dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se dispozitivi i aktgjykimit është i pa qartë dhe kundërthënës me brendinë e vete përkitazi me faktet vendimtare si dhe arsyet e prezantuara në arsyetimin e këtij aktgjykimi dhe përmbajtjes së vet shkresave të lëndës, po ashtu ankuesi ka pohuar se i takon e drejta në 20 % për faktin se ka punuar në ndërmarrje prej datës 18 korrik 1972 deri në qershor të vitit

1999 ku për shkak të frikës për familjen e tij dhe nga rrethanat e njohura botërisht ka braktisur Ferizajn dhe nuk ka mundur të jetë në marrëdhënie pune pasi që ka qenë i diskriminuar ngase është i nacionalitetit serb. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas braktisjes së qytetit të Ferizajt ka kontaktuar me udhëheqësit e ndërmarrjes për tu kthyer në punë por nga të njëjtit i është thënë se nuk mund të garantojnë për jetën e tij dhe të familjes andaj nuk ka pasur guxim që të vie pas lufte dhe të vazhdoj punën.

Ankesa e lartcekur i është dorëzuar AKP-së me datë 06 gusht 2018 dhe e njëjta nuk ka parashtruar përgjigje.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie të re të punës prej datës 25 mars 2003, andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie punën në NSH "N" më datë 18 korrik 1972 ndërsa librezën e punës e ka ende të hapur, po ashtu nga librezja e punës vërtetohet fakti se ankuesi nga data 25 mars 2003 ka krijuar marrëdhënie të re pune në një ndërmarrje tjetër, Andaj në bazë të këtyre fakteve ankuesi ka mundur të jetë punëtor i NSH "N" në kohën e privatizimit të NSH-së dhe kështu mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur e drejta e përfshirjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së. (shif arsyetimin ligjor, diskriminimi).

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e bazuar dhe obligon AKP-në që punëtorin **D. (M) S**, të përshijë në listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i Nsh-së " N", Ferizaj.

A0021 M. (S) S (C-0017)

Me 31 maj 2016 **Ankuesi A0021 – M. (S) S**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 182.2 nën pikën e LPK-së, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike nga neni 183.1 të LPK-së dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se dispozitivi i aktgjykimit është i pa qartë dhe kundërthënës me brendinë e vete përkitazi me faktet vendimtare si dhe arsyet e prezantuara në arsyetimin e këtij aktgjykimi dhe përmbajtjes së vet shkresave të lëndës, po ashtu ankuesi ka pohuar se i takon e drejta në 20 % për faktin se ka punuar në ndërmarrje prej datës 15 shkurt 1969 deri në qershor të vitit 1999 ku për shkak të frikës për familjen e tij dhe nga rrethanat e njohura botërisht ka braktisur Ferizajn dhe nuk ka mundur të jetë në marrëdhënie pune pasi që ka qenë i diskriminuar ngase është i nacionalitetit serb. Po ashtu ankuesi ka pohuar se pas braktisjes së qytetit të Ferizajt ka kontaktuar me udhëheqësit e ndërmarrjes për tu kthyer në punë por nga të njëjtit i është thënë se nuk mund të garantojnë për jetën e tij dhe të familjes andaj nuk ka pasur guxim që të vie pas lufte dhe të vazhdoj punën.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka krijuar marrëdhënie të re të punës prej datës 01 prill 2003, andaj gjykata ka vendosur se provat e disponuara tregojnë si ai nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me ndryshime.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës e dorëzuar si provë pranë Kolegjit të Specializuar, vërtetohet fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie punën në NSH " N" më datë 15 shkurt 1969 deri më 29 janar 1979 dhe përsëri nga data 03 janar 1980, ndërsa librezën e punës e ka ende të hapur, po ashtu nga librezat e punës vërtetohet fakti se ankuesi nga data 01 prill 2003 ka krijuar marrëdhënie të re pune në një ndërmarrje tjetër, andaj në bazë të këtyre fakteve ankuesi nuk ka mundur të jetë punëtor i NSH " N" në kohën e privatizimit të NSH-së dhe kështu nuk mund të përfitoj nga pjesa e 20% të shitjes së ndërmarrjes pasi që nuk e plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, kusht i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 neni 10.4, për të ju njohur drejta e futjes në listën përfundimtare me të drejta legjitime për të përfituar nga shitja e një pjese të të ardhurave të NSH-së.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se sa i përket ankuesit të lartcekur, Ankesa është e pabazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

A0022 S. (R) Sh (C-0056)

Me 28 qershor 2016 **Ankuesi A0022 – S. (R) Sh**, ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit, SCEL11-0057, të datës 18 prill 2016, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të aprovohet kërkesa e tij për futje në listën përfundimtare. Ankuesi ka pohuar se gjykatës i është prezantuar librezat e punës me nr. 6450/75 me datë të fillimit e cila është hapur me 10 janar 1977 dhe nga e cila vërtetohet se ka punuar deri në vitin 1999 pa ndërprerje në Ferizaj, po ashtu ankuesi ka pohuar se shumë punëtor nuk kanë mundur ti përcjellin shpalljet e privatizimit.

Kolegji i Specializuar sa i përket këtij ankuesi ka konstatuar se NSH-ja është privatizuar më 01 qershor 2007, lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime është shpallur me 27,28 dhe 29 tetor 2011 dhe afati i fundit për paraqitjen e ankesave në DHPGJS ka qenë 19 nëntor 2011 ndërsa ankuesi ka parashtruar ankesë më 13 janar 2012, jashtë afatit të paraparë ligjor.

Kolegji i Apelit vlerëson se konstatimi i Kolegjit të Specializuar sa i përket këtij ankuesi është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga shkresat e lëndës, shihet se ankesa i është drejtuar AKP-së më 13 janar 2012 dhe e cila ka mbërritur në DHPGJS më datë 24 janar 2012 por që konsiderohet se ankuesi gabimisht i është drejtuar me ankesë AKP-së dhe si ditë e dorëzimit të ankesës në gjykatë konsiderohet data 13 janar 2012. Në bazë të shpalljes së listës përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime nga AKP-ja, afati i fundit për paraqitjen e ankesave në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme ka qenë data 19 nëntor 2011, në rastin konkret, nga ana e ankuesit nuk është respektuar afati për paraqitjen e ankesës, ashtu që ankesa është parashtruar pas kalimit të afatit, ndërsa arsyet e dhëna nga ankuesi për lëshimin e afatit Kolegji i Apelit i vlerëson si të pa bazuara dhe pa ndikimin në vendosjen ndryshe nga Kolegji i Specializuar.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se Ankesa është e pabazuara dhe rrjedhimisht Aktgjykimi ankimor sa i përket këtij ankuese vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Ankesa e AKP-së dhe vlerësimet e Kolegjit të Apelit

Me 18 maj 2016 **Ankuesja A0007- AKP-ja**, ka parashtruar ankesë kundër pikës së parë përveç ankuesit C-0055 dhe pikës së pestë të Aktgjykimit, SCEL-11-0057 të datës 18 prill 2016. AKP-ja ka pohuar se në bazë të arsyetimit ligjor të aktgjykimit, për një pjesë të ankuesve, si arsye kryesore, përfshirjen e punëtorëve në listën përfundimtare me të drejta legjitime për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së është diskriminimi. Sipas ankueses ankuesi duhet të ofrojë fakte dhe prova nga të cilat mund të parashikohet diskriminimi direkt apo indirekt dhe vetëm nëse këto fakte dhe prova parashtrohen e paditura duhet të sjellë kundër argumente dhe prova se nuk ka pasur qasje diskriminuese, sipas ankueses nuk është kontestuese se ka patur diskriminim dhe atë në të dy anët, por konsideron se diskriminimi është një akt individual dhe në secilin rast konkret duhet të provohet, pasi në kontestin e mbrojtjes nga diskriminimi është

shumë vështir që me siguri të provohet që pabarazia në qasje është motivuar nga ndonjë prej veprimeve të ndaluara diskriminuese, po ashtu ankuesja ka pohuar se në rastin konkret asnjë ankues i nacionalitetit serb që është përfshirë në listën përfundimtare nuk ka prezantuar fakte relevante në bazë të të cilave kishte për tu vërtetuar faktin e tretmanit jo të barabartë dhe arsyetimin për aplikimin e diskriminimit direkt apo indirekt në pajtim me nenin 8.1 të Ligjit kundër Diskriminimit, ndërsa sa i përket ankueses C0052 V. N në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar ajo gjendet në mesin e ankuesve nën pikën I të pranuarit, ndërsa në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar konstatohet se ankesa e saj refuzohet si e pa bazuar, andaj konsideron se është bërë gabim teknik dhe se ankesa e ankueses sipas arsyetimit të aktgjykimit të atakuar duhet të refuzohet. AKP-ja e atakon edhe pikën e pestë të dispozitivit të aktgjykimit të lartcekur duke specifikuar të dhëna për secilin ankues të cilët duhet të mbesin në listën përfundimtare me të drejta legjitime. AKP-ja konsideron se aktgjykimi i kundërshtuar i Dhomës së Posaçme është jo konsistent, i pa argumentuar në bazë të ligjit të aplikueshëm, nuk i përmban faktet vendimtare dhe në mënyrë arbitraren e interpreton drejtën e aplikueshme.

C0001 I. (I) G

Më 01 nëntor 2011, ankuesja **I (I) G**, ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme kundër të paditurës AKP-së, duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar pjesën prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH " N" Ferizaj. Ankuesja ka pohuar se ka punuar në NSH nga data 10 janar 1977 deri sa i është dashur ta lëshoj Kosovën më 19 qershor 1999. Si provë ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së punës, kopjen e letërnjoftimit, kopjen e vërtetimit nr. 433 të datës 07 prill 1999, kopjen e aktvendimit të datës 15 qershor 1999, kopjen e vendimit të datës 27 maj 1997, kopjen e vendimit të datës 23 shtator 1998 dhe kopjen e aktvendimit të datës 24 tetor 1983.

Më 22 nëntor 2011, e paditura ka parashtruar përgjigje duke pohuar se ankuesi nuk ka qenë i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit andaj edhe

nuk mund të hyjë në listën përfundimtare të punëtorëve siç parashihet në rregulloren e UNMIKU-ut nr. 2003/13, në nenin 10.4.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankuesë ka konstatuar se ankuesja do ti kishte plotësuar kushtet e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar, po të mos kishte qenë e diskriminuar.

Kolegji i Apelit vlerëson si të drejtë dhe të bazuar në ligj përfundimin e Kolegjit të Specializuar lidhur me këtë ankuesë. Nga gjendja faktike e vërtetuar dhe nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës shihet që ankuesja ka krijuar marrëdhënie punë në NSH nga data 10 janar 1977 dhe librezën e ka ende të hapur, po ashtu ankuesja pretendon se e ka lëshuar Kosovën më 19 qershor 1999. Kolegji i Apelit vlerëson se koha kur e ka lëshuar ankuesja vendin e punës dhe Kosovën ka qenë kohë që ka mbizotëruar pasiguria e kësaj ankuesë për vetën dhe familjen e saj për shkak të përkatësisë etnike që ka dhe se kjo pasiguri për punëtorët e nacionalitetit serb ka vazhduar edhe pas përfundimit të luftës, andaj nga kjo vie përfundimi se ankuesja ka qenë e diskriminuar sa i përket vazhdimin të marrëdhënies së punës dhe kësajsoj e njëjta i plotëson kushtet ligjore nga neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar për tu përfshirë në listën përfundimtare të të punësuarve me të drejta legjitime, deri tek ky përfundim vie edhe për faktin se e paditura me asnjë provë nuk e dëshmon faktin se ankuesja nuk ka ofruar shërbime për NSH, se e njëjta nuk i është nënshtruar diskriminimit, apo se të njëjtës ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës me vendim të ligjshëm.

Nga këto arsye ankesa e AKP-së lidhur me këtë ankuesë refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet pika e -I- e aktgjykimit të ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

C0002 Lj. () S C

Më 03 nëntor 2011, ankuesja **Lj. (P) S C**, ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme kundër të paditurës AKP-së, duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfutur pjesën prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH " N" Ferizaj. Ankuesja ka pohuar se ka punuar në NSH nga

data 01 shtator 1966 deri në qershor të vitit 1999, po ashtu ankuesja ka pohuar se pas vitit 1999 për shkak të frikës për veten dhe familjen e saj e nga rrethanat e njohura e ka braktisur qytetin e Shtimes. Ankuesja e konsideron veten të diskriminuar për shkak se është e nacionalitetit serb. Si provë ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së punës.

Më 22 nëntor 2011, e paditura ka parashtruar përgjigje duke pohuar se ankuesja nuk ka parashtruar ankesë ndaj listës së përkohshme andaj e njëjta duhet të hedhet poshtë si e pa pranueshme.

Kolegji i Specializuar lidhur me këtë ankuese ka konstatuar se ankuesja do ti kishte plotësuar kushtet e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar po të mos kishë qenë e diskriminuar.

Kolegji i Apelit vlerëson si të drejtë dhe të bazuar në ligj përfundimin e Kolegjit të Specializuar lidhur me këtë ankuese. Nga gjendja faktike e vërtetuar dhe nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kopja e librezës së punës shihet që ankuesja ka krijuar marrëdhënie punë në NSH nga data 01 shtator 1966 dhe librezën e ka ende të hapur, po ashtu ankuesja pretendon se e ka lëshuar qytetin e Shtimes për shkak të frikës që kishte për vete dhe familjen e saj. Kolegji i Apelit vlerëson se koha kur e ka lëshuar ankuesja vendin e punës dhe vendbanimin e saj ka qenë kohë që ka mbizotëruar pasiguria e kësaj ankuese për vetën dhe familjen e saj për shkak të përkatësisë etnike që ka dhe se kjo pasiguri për punëtoret e nacionalitetit serb ka vazhduar edhe pas përfundimit të luftës, andaj nga kjo vie përfundimi se ankuesja ka qenë e diskriminuar sa i përket vazhdimin të marrëdhënies së punës dhe kësaj e njëjta i plotëson kushtet ligjore nga neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar për tu përfshirë në listën përfundimtare të të punësuarve me të drejta legjitime, deri tek ky përfundim vie edhe për faktin se e paditura me asnjë provë nuk e dëshmon faktin se ankuesja nuk ka ofruar shërbime për NSH, se e njëjta nuk i është nënshtruar diskriminimit, apo se të njëjtës ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës me vendim të ligjshëm.

